BIOLOGJIA E DRURËVE. IDENTIFIKIMI I DRURËVE

- Cilat janë disa nga karakteristikat kryesore që duhen njohur për të bërë të mundur identifikimin e specieve?
- Si i identifikoni speciet që nuk jeni familjar me to?
- Si na ndihmon aftësia për të identifikuar llojet në punën tonë, veçanërisht kur punojmë konkretisht me një grup lokal?

CFARË ËSHTË DENDROLOGJIA?

- Dendrologji -"studimi i pemëve" ose shkenca që studion drurët, ndryshe si mënyra për të klasifikuar speciet drusore (taksonomi), që nuk është gjë tjetër veçse klasifikimi, emërtimi dhe identifikimi i pemëve në bazë të kërkesave dhe mardhënieve natyrale si dhe shtrirjen gjeografike të specieve (areali).

CFARË ËSHTË NJË PEMË (DRURI)?

- *Një pemë është një bimë drusore me disa karakteristika dalluese si*:
- Arrin lartësinë në maturi të paktën mbi 6 m.
- Ka një trung ose disa trungje dominant në të njëjtën kohë.
- Normalisht nuk ka degë në pjesën e poshtme të trungut.
- Ka kurorë të dallueshme sikur dhe të pjesëshme.
- Zakonisht është më e madhe se bimët e tjera dhe jeton më gjatë.

NDARJA E PEMËVE

Dy klasifikime kryesore të pemëve:

- Gjimnosperme (farëzhveshurat, halorë)
- Angjiosperme (farëveshurat, fletorë)

GJIMNOSPERMËT
përherëblertë

Halorët

pishat, cedrat, selvitë etj

ANGIOSPERMËT

- Fletorët – gjetherënës + (palmat dhe jukat)

Zakonisht këta drurë e humbin gjethëzimin e tyre në vjeshtë dhe zhvillojnë të reja në pranverë.

TAKSONOMIA (KATEGORIZIMI) E PEMËVE

1. **Klasifikimi, që është baza për dy komponentët e tjerë.**
2. **Emërtimi i pemëve.**
3. **Identifikimi i pemëve**

Klasifikimi	Përcaktimi
Mbretëria (Ndarja)	Gjithë gjallesat janë të klasifikuara nën mbretëri (bimë dhe kafshë) Pemët janë nën mbretërinë e bimëve
Divizioni (Nënndarja)	Kjo është kategoria e parë e mbretërisë së bimëve dhe është e bazuar në pjesët e bimëve për riprodhim. Pemët Spermatofite janë ato bimë që riprodhohen me farë.
Klasa	Më pas pemët ndahen në dy klasa, Gjimnospermët dhe Angjiospermët, kjo sipas metodës sesi zhvillohen farat që përdoren për riprodhim. Gjimnospermët siç janë halorët, prodhojnë fara të hapura në një strukturë që është boçja. Angjiospermët janë pemë që lulëzojnë dhe farat i kanë të mbyllura në vezore.
Rendi	Pemët më tej janë të klasifikuara në rende sipas disa karakteristika të tjera të riprodhimit me fara. Angjiospermët janë të ndara në dy grupe kryesore: monokotilodonet dhe dikotilodonet, bazuar pjesërisht në nr. e gjetheve embrionale (një ose dy) në farat e bimëve. Shumica e pemëve janë dikotilodone.
Familja	Janë një grup pemësh me lidhje të përbashkëta. Familja e trëndafilave (Rosaceae) është një familje në grupin dikotilodon dhe përfshin qershinë, mollën, kumbullën dhe pemën e pjeshkës.
Gjinia	Një përmbledhje e specieve me lidhje të përbashkëta përbëjnë gjininë. Speciet janë strukturalisht të ngjashme ose kanë paraardhës të përbashkët. Shembull është qershia dhe kumbulla, Prunus, që janë pjesë të familjes së trëndafilave.
Specie	Bashkim individësh me karakteristika të ngjashme që tregojnë se kanë paraardhës të përbashkët, një specie është një pemë e dallueshme dhe e pangjashme me të tjerët.

Termi	Përcaktimi
Hibrid	Nga kryqëzimi i dy specieve te ndryshme.
Varietet	Specie që ka karakteristika te pakta të ndryshme.
Kultivar	Pemë që është kultivuar për prodhim specifik.
Kloni	Popullatë pemësh që zhvillohet aseksualisht nga një pemë e vetme (vegjetative).
Vendase	Pemët vendase të një rajoni të caktuar
Ekzotike	Pemë që nuk janë vendase. Kur këto pemë rriten dhe riprodhohen në një rajon të ri quhen specie të natyralizuara.

EMËRTIMI I PEMËVE

- Emërtimi me emra latin është komponenti i dytë i taksonomisë së pemëve. Secila specie ka një emër latin që përdoret universalisht. Megjithatë, secila pemë ka dhe emërtime me emra të zakonshëm që mund të njihet në rajone të ndryshme.
- *Emri shkencor*

Një sistem i standartizuar latin i emërtimeve të bimëve është zhvilluar që prej shek. 18 dhe përdoret në të gjithë botën si një sistem i unifikuar për emërtimin e pemëve. Emërtimi i plotë për një specie konsiston në tre pjesë:

Gjinia, për pishën e zezë është Pinus
Specia, për pishën e zezë është Pinus nigra
Emri i plotë Pinus nigra L (që është iniciali i botanistit suedez Linnaeus i shek. 18).

- *Emrat e zakonshëm*

Emrat e zakonshëm të pemëve shpesh përfaqësojnë karakteristikat e tyre kryesore, siç janë psh. dëllinja e kuqe. Emërtimi gjithashtu mund të lind dhe prej burimeve të tjera siç është vendi ku rritet natyrisht pema apo forma psh Ajdesi i alpeve (Laburnum alpinum), Shelgu vajtues (Salix babilonica), Bushi (Buxus sempervirens).

ose:

- **Habitati – Vidh fushe**
- **Tipar dallues – manjola lulemadhe**
- **Rajoni – Liguster kineze**
- **Përdorimi – Gështenja e kalit**
- **Përkujtimore – Robinia (Gledicja)**
- **Përshtatje nga gjuhë të tjera - Cedër**

IDENTIFIKIMI I PEMËVE

Identifikimi i pemëve është aspekti i tretë i taksonomisë ose i klasifikimit. Pemët janë të klasifikuar në grupe kryesisht prej frutave dhe luleve por gjethet dhe bisqet janë më të dukshme për tu identifikuar. Identifikimi i pemëve në zona urbane ka nevojë për njohje të shumë llojeve sepse shpesh ka dhe specie ekzotike që janë futur në vend. Tiparet dalluese për identifikim të pemëve janë:

- **Gjethet**
- **Bisqet dhe sythat**
- **Lëvorja**
- **Lulet**
- **Frutat dhe farat**
- **Boçet (konet)**

Çelësat

- **Çelësat janë sisteme orientimi që identifikojnë pemët në bazë të tipareve.**
- Çelësi shpesh fokusohet tek frutat ose lulet meqë këto janë kërkesat kryesore për klasifikimin e pemëve. Megjithatë çelsat janë zhvilluar dhe për tipare dhe veçanti të tjera të pemëve si: gjethet, trungu, sythe dhe lëvore. Përdorimi i çelësit përfshin zgjedhje në çdo hap.

Gjethet

Një rrugë për të identifikuar pemët janë dhe gjethet. Gjethet mund të kenë karakteristika të dallueshme të cilat mund të përdoren për identifikim. Secila nga këto tipare dalluese do të ilustrohen në këtë kapitull siç janë:

- **Pjesët e gjethes**
- **Lloji i gjethes**
- **Tipi i gjethes**
- **Forma e gjethes**
- **Vendosja në kërcell e gjetheve**
- **Buzët e gjetheve**
- **Sipërfaqja e gjetheve**

Kemi dy lloje gjethesh, fletore dhe halore.

- Gjethja fletore është e thjeshtë ose e përbërë.
- Një gjethe e thjesht ka vetëm një gjethe (fletë).
- Gjethet e përbëra kanë dy ose më shumë fletë (gjethe) që quhen gjethëza.

Gjethe të thjeshta



Gjethe të përbëra



Tekpendore e përbërë

çiftpendore e përbërë

Dyfishpendore e përbërë

Pëllëmbore e përbërë

Format e gjetheve fletore



Format e gjetheve halore

Gjethet si bizë janë të zgjatura, konike deri në një farë pike dhe zakonisht janë të mprehta kur i prek. Psh dëllinjat i kanë gjethet si bizë.

Fig. 6, luspa

Këto lloje gjethesh të japing ndjesinë se janë të buta kur preken, psh tuja.

Fig. 7, hala

Këto lloj gjethesh përfaqësojnë mësë miri familjen e pishave. Nr. i halave ose gjatësia mund të jenë element të rëndësishëm në identifikim.

Vendosja e gjetheve

Duke shikuar sesi janë të vendosura gjethet në kërcell mund të dallojmë përsëri një specie nga një tjetër. Ka tre lloje vendosje të gjetheve: të kundërta, rrethuese dhe të alternuara.

Fig 9 të kundërta

Gjethet e vendosura në mënyrë të kundërt i referohet dhe atyre gjetheve që megjithëse janë të vendosura në një kërcell janë të kundërta me njëra tjetrën si pozicion.

Fig. 10 rrethuese

Tre ose më shumë gjethe të vendosura në një nyje, quhen gjethe rrethuese.

Fig. 11 të alternuara (të këmbyera)

Mënyra e vendosjes së alternuar të gjetheve është kur një gjethe është e vendosur tek secila nyje, që formojnë një spirale në gjatësinë e kërcellit.

Nervaturat e gjethes

Nervaturat gjithashtu ndihmojnë në identifikim lloji. Katër janë vendosjet kryesore të nervaturave: pendore, pëllëmbore, paralele dhe dikotomike (dysuara).

Fig. 12

Nervatura pendore kanë një nervaturë qëndrore të zgjatet nga baza. Duket si kurriz peshku.

Fig. 13

Nervaturat pëllëmbore quhen kur tre ose më shumë nervatura zgjaten që nga baza e gjethes.

Fig. 14

Nervaturat vazhdojnë parallel me njëra tjetrën përgjatë gjithë gjatësisë së gjethes.

Fig. 15

Nervaturat dikotomike zgjaten dhe formojnë një formë "Y".

Majat dhe baza e gjetheve



Ngushtë *Majëmprehtë* *Rrumbullakosur* *E cungët* *Majëngrënë* *Me thumb*

Rrumbullakosur *E ngushtë* *Formë pyke* *Jo e drejtë* *Si zemër*

Buzët e gjethes

E plotë *Dhëmbë dhëmbë* *E sharruar* *Dyfish e sharruar*

E shqyer *Rripëzura* *E vrigullt* *Valë valë*

Bisqet dhe sythat

Bisk është ajo pjesë e re e kërcellit ose e degës që mban mbi vete gjethe dhe sytha.

- bisqe të gjatë ose makroblaste
- bisqe të shkurtër apo mikroblaste

Brakiblastet janë degë të shkurtëra që formohen nga grumbullimi i rritjeve vjetore të mikroblasteve që zakonisht mbajnë lulet dhe përfundojnë me një syth ose gjemb.

Sythat: kemi sythin e majës, sythin lateral (sqetullorë) dhe mitakë (të fjetur).



- të gjethes (vegjetativ)
- të lules

Lëvorja

- Lëvorja është një nga veçoritë që ndihmon jashtëzakonisht në identifikimin e pemëve, sdomos gjatë periudhës kur pemës i bien gjethet. Lëvorja tek ekzemplarët e rinj ndryshon nga ajo e një të rrituri. Rëndësi ka forma, tekstura, trashësia apo dhe ngjyra.

E lëmuar *I rrudhur* *Me luspa* *Me gunga* *I ashpër*



Lulet

Sipas mënyrës së shpërndarjes së luleve në dru dallohen:

- dru monoikë (kur tek një ekzemplar dalin të veçuara lulet mashkullore dhe femërore)
- dru dioikë (kur lulet njëseksore mashkullore dhe femërore ndodhen në ekzemplarë të ndryshëm)
- drurë poligamë (tek i njëjti ekzemplar takohen lulet hermafrodite po ashtu dhe njëseksore)



Frutat dhe farat

- **Frutat zhvillohen nga farat.**
- **Lulet e vetmuara kanë një pistil të vetëm dhe prodhon një frut të vetëm.**
- **Disa fruta kanë vetëm një farë ndërsa të tjerë zhvillojnë shumë fara.**
- **Në shumicën e specieve polenizimi dhe fertilizimi duhet të ndodhë që frutat të zhvillohen.**

Disa shembuj të tipeve të ndryshme frutash janë:

Mollë **Hurmë (berry)** **Qershi** **Arrë (bërthokël)** **Akenë**

Dyshojzë **kapsulë** **bishtajë** **frut i shumëfishtë**

- **Frutat e thjeshtë**

Ka dy tipe bazike, të thatë dhe mishtorë (tulorë), ku secila ka nën variantet e veta.

- Dy format e frutave të thatë janë:
- Jo çahës në maturi (akene, lëndet)
- çahës në maturi (bishtajat).

Jo çahësit janë fruta të një fare zakonisht si tek panja apo dushqet. Frutat çahëse përbëhen nga shumë fara dhe janë të mbyllur në një mbulese derisa çahet në pjekuri si psh manjola.

Frutat mishtore janë zakonisht me shumë fara dhe farat janë të rrethuara nga tul mishtor ose perikarpi, që në disa raste është i ngrënshëm. Këtu mund të futen specie si: hurma, boronica, molla ose dardha etj.

- **Frutat e përbërë**

Frutat që zhvillojnë më shumë se një pistil quhet të përbëra. Ato ndahen në dy tipe grumbuj dhe shumëfishe.

- Të thatë dhe tulorë
- Frutat grumbuj zhvillohen nga një lule e vetme që ka shumë pistil.
- Kur disa lule sëbashku kontribuojnë në zhvillimin e një fruti të vetëm, atëherë ky quhet frut i shumëfishtë, si tek fiku, manaferra, molla, dardha etj.

Boçet

- Farat te halorët gjenden në boçe. Shumica e halorëve janë monoikë, që dmth si lulet mashkullore dhe femërore dalin të veçuara në të njëjtën pemë. Vetëm disa halorë janë poligamë, ku organet riprodhuese janë në pemë të ndryshme. Strukturat e riprodhimit femëror dhe mashkullor quhen boçe.

Boçe (kone)

Forma dhe gjendja e drurëve

Ka dy forma drurësh (pemësh):

- Ato lloje drurësh që kanë trung dominant dhe degë më pak, kryesisht halorët dhe që i japin pemës një formë konike.
- Gjithashtu kemi dhe drurë që e kanë kurorën të zhvilluar me degëzime të mëdha, pra një formë e rrumbullakët (ovale).

Një pemë zhvillohet ndryshëm në varësi të vendit ku mbillet, kështu që dhe paraqitja e saj do të ndryshojë. Një pemë që rriten e lartë në një areal të vetin, ka shumë mundësi që në ekstremet e këtij areali të zhvillohet si një shkurre.

Si ndikon mjedisi urban në identifikimin e specieve?

- *Madhësisa, forma dhe zhvillimi*
  Pemët në kushtet e mjedisit urban rriten në kushte të tjera dhe shpesh janë më të vogla dhe më pak të zhvilluara sesa ato në pyje për një sërë arsyesh.
- Specie modele (të vetme)
- Areali (shtrirja) mund të ndryshojë
- Futja në zona të reja (natyralizimi)
- Kushtet e tokës
- Krasitja

Specie modele (të vetme)

Ekspozim me më tepër dritë, erë dhe temp më të larta.

Betula pendula - Mështekna

Specie e vetme **Në grumbuj**

Areali (shtrirja) mund të ndryshojë

(Futja në zona të reja (natyralizimi)

Kushtet e tokës

Volum toke i pakët, ngjeshje, drenazhim, ajrosje e pakët dhe nutrient të pakët.

Krasitja

Krasitja ndryshon formën natyrale të pemës duke e vështirësuar identifikimin.

Rrethi i Përmetit

Pyjet e Përmetit

I - Bimësia e luginës së Vjosës

II - Parku Kombëtar "Bredhi i Hotovës-Dangëlli"

Pellgu i Vjosës

- Pellgu i Vjosës ka një pasuri floristike (bimësi) të madhe, si në lloje dhe në shtrirje. Ky pellg shpreh të gjithë ndërveprimin e ndërsjelltë të ekologjisë, kushteve klimatike, përbërjes së tokës etj

Çfarë bimësie mund të takojmë në këtë pellg ujëmbledhës?

- Për shkak të mikroklimës së butë në një pjesë të rajonit, këtu rriten bimësi me gjelbërim të përhershëm: mareja, shqopa, xina, përralli, dëllinja, ilqe, mrete, gjineshtra etj. Makja
- Në territore me klimë më të ashpër e malore takohen pyjet fletëgjerë dhe halorë. (ahu, pisha, bredhi etj)
- Bimësia është e përhapur në kate por është e vështirë të dallohet kufiri në mes këtyre kateve. Kjo për shkak të karakterit malor të zonave. Katet drunore fillojnë me brezin e shkurreve, dushqeve, pyjet gjethorë, ato halorë dhe përfundon me kullotat alpine.

Photo credit: EcoAlbania

Pellgu i Vjosës

- Hapësirat më të mëdha të pellgut të Vjosës mbulohen me shkurre të tipit mesdhetar me gjelbërim të përhershëm e gjetherënës.
- Ato takohen në lartësitë nga 100-130 m dhe deri 600-800 m mbi nivelin e detit.
- Në pjesën jugore dhe perëndimore të shpateve shkurret arrijnë deri në 800 m dhe ndërsa në ato veriore dhe lindore deri në 600 m mbi niveil e detit.

1-Flora e pyjeve mesdhetar

Përfshin pyje me pishë të egër si dhe dushkaja përherë dhe gjysmë të blertë ku hyjnë:

Flora e pyjeve halorë mesdhetar:

Në grykën e Kelcyrës kryesisht. Speciet halore përfaqësohen nga Pisha e egër (Pinus halepensis Miller), pisha e butë (Pinus pinea L.) kurse fletorët janë vënja (Quercus robur L.), plepi i bardhë (Populus alba L.), vërriu i zi(Alnus glutinosa L.) etj.

Nga shkurret kemi dëllinja e kuqe (Juniperus oxycedrus L.), mërsina (Myrtus communis L.), shqopa (Erica arborea L.), xina (Pistacia lentiscus L.).

Nga bimësia barishtore përfaqësohet nga lloje psamofite, halofite, hidrofile, e kserofile me specie si Aster albanicus paparistoi, Orchis albanica etj.



Flora e dushkajave përherë të blerta

- Kjo florë pyjore është karakteristike për pyjet me ilqe (Quercus ilex)
- Kati i shkurreve është i pasur me lloje si: Xina (Pistacia lentiscus L.), mare (Arbutus unedo), shqopa (Erica arboreal.) etj.
- Bimësia barishtore në këtë tip vegjetacioni përfaqësohet nga: Viola alba bess, Cyclamen hederifolium Ait, Linum bienne Miller, Briza maxima L. etj.

Flora e dushkajave gjysëm të blerta

- Tipet e pyjeve në këtë pellg përbëhen kryesisht nga Bulgër (Quercus trojana webb.) der inë lartësinë 800 m mbi nivelin e detit. Gjenden të thjeshtë dhe të përzier me Mëllezë (Ostrya carpinifolia), shkozë të zezë (Carpinus orientalis Mill), frashër fletë ngushtë (Fraxinus angustifolia Vahl.), qarr (Quercus cerris L.).
- Llojet shkurrorë në këtë pellg janë: Dëllinja e kuqe (Juniperus oxycedrus L.), driza (Paliurus spina christi Miller), kulumbria (Prunus spinosa L.) etj
- Bimësia barishtore përfaqësohet nga: Festuca heterophylla Lam, Ononis spinosa L.,Dactylis glomerata etj.

Flora e zonës së dushkajave

- Tipet e pyjeve përbëhen nga dushkaja gjetherënëse dhe e gështenjave si: Shparthi (Quercus frainetto Ten.), bungëbuta (Quercus pubescens ëilld.).
- Në katin shkurror hasim këto lloje shkurresh: murrizi njëbërthamësh(Crataegus monogyna), Cërmëdelli (Cotinus cogyria Scop), dëllinja e kuqe (Juniperus oxycedrus L.) etj.
- Kati barishtor paraqet larmi me lloje si: Helleborus odorus waldst. Kit, Digitalis grandiflora Miller etj.

Flora e zonës së ahut

- Flora me pishë të zezë
- Mbizotron pisha e zezë (Pinus nigra Arnold) por takohen dhe përzierje të pakta me bredh (Abie alba Mill.) dhe ah (fagus sylvatica L.). Lartësia ku gjendet kjo bimësi është kryesisht midis 600 – 1400 m mbi nivelin e detit.
- Shkurret përfaqësohen nga thanukla (cornus sanguniea L.), shkoza e bardhë (Carpinus betulus L.), boronica (Vaccinium myrtillus L.), miedra (Rubus idaeus L.) etj.
- Flora barishtore është e pasur me lloje si: grathateli (Erica herbacea L.), Melica uniflora Retz, Brachypodium sylvaticum Beauv. etj.

Flora e pyjeve me ah

- Lloji dominues është ahu (Fagus sylvatica L.) por ka dhe përzierje me Abies alba Mill., Panja e malit (Acer pseudoplatanus L.), vadhja e egër (Sorbus aucuparia L.), plepi i egër (Populus tremula L.) etj.
- Ahu megjithëse ka një kurorë të madhe lejon rritjen e llojeve barishtore hijedashës dhe në periferi ato dritëdashëse si: Atropa belladonna L., Galium odoratum L., Lilium Martagon L. etj.
- Disa lloje endemike, subendemike dhe ballkanike që gjenden në zonën e ahut janë: Cistus albanicus Earburg., Lilium albanicum Jav. etj.

Flora e pyjeve me rrobull

- Këto pyje me rrobull (Pinus heldreichii) takohen në ekstremin e sipërm të zonës së ahut mbi formacione gëlqerore ose serpentinore de në disa raste në të çarat e shkëmbinjëve. Gjendet pak i shoqëruar me ah, bredh, arnen apo pishë të zezë.
- Nga shkurret ndeshim: dëllinja e zezë (Juniperus communis L.), Boronica etj.
- Kati barishtor ka lloje si: Genista hassertiana K. Richter., Forsythia europea Deg.et Bald. Etj.

Flora e pyjeve me Bredh maqedonie

- Këtë tip e ndeshim në pjesën e poshtëme të pellgut të lumit Vjosa. Në përgjithësi formon pyje të thjeshtë, por në Hotovë përzihet me bungëbutë, shkozë të zezë, mëllezë etj.
- Kati shkurror përfaqësohet me lajthinë e egër (Corylus colurna L.), shelgu kërcjellpështjellës (Salix amplexicaulis) etj.
- Mbulesa barishtore përfaqësohet nga: Hypericum Rimeluacum Boiss, Festuca altissima All etj.

II - Parku Kombëtar "Bredhi i Hotovës-Dangëlli"

- Vendim i minstrave të dates 17.12.2008.
- Në rrethin e Përmetit, Skraparit dhe të Kolonjës.
- Sipëfaqja aktuale është 34,361.10 ha në very të luginës së Vjosës.
- Parku është i pasur në bimë endemike, subendemike, ballkanike dhe mesdhetare.
- Vlerat natyrore, peizazhike dhe ato historike e kulturore ofrojnë vlera dhe potenciale të mëdha për zhvillimin e turizmit ekologjik e kulturor.

Kufinjtë

Parku shtrihet në lartësitë nga 600 – 1500 m mbi nivelin e detit.

1. Veri: Kuota 1 291,3m (Maja e Qarrishtës)
2. Lindje: Kuota 1 356m (Qafa e Dëllinjës)
3. Jug: Pika e ndërprerjes së lumit të Çarçovës me Përroin e Postenanit
4. Perëndim: Ura e Çarçovës
5. Parku përfshim dy lugina: Lomnica dhe dy kanionet e Kamneca dhe Borocka, gjithashtu dhe kanioni i Langaricës.



Formacioni bimor kryesorë

Bredhi i maqedonisë – Abies borisii regis – Macedonian fir

- Përbën bimësinë tipike të këtij parku
- Takohet kryesisht në malin
1. Kokojka
2. Frashër
3. Hotovë
4. midis fshatrave Kaludh e Petran.
- Ka origjinë të ndryshme biogjeografike
- Mbetje e formacioneve më të pasura bimore mesdhetare (relik bimor)
- Është shpallur Park Kombëtar në vitin 1996.

Toka pyjore janë:

- **Toka pyjore dhe pyje të përzier - 24037 ha ose 70% e sip.**
- **Kullota – 5311 h ose 15 % e sip.**
- **Ujra – 204 ha ose 0.6 % e sip.**
- **Toka urbane – 179 ha ose 0.5 %**
- **Toka bujqësore – 22230 ha ose 6.4 % e sip.**



Ndarja e sipërfaqes sipas zonave

1. **Piskovë – 1796 ha**
2. **Frashër – 2900 ha**
3. **Petran – 1486 ha**
4. **Carçovë – 442 ha**



Pronësia Bashki (komunë) / Shtet

- **Zona qëndrore (core area):**
1. **Frashër/ Piskovë/ Qendër**

Harta e shpëndrajes së bimësisë

Zonat fitoklimatike të Shqipërisë

Zonat apo territori ku shtrihen drurët, me një kufi të qartë quhet areal. *Areali është shprehja e përshtatjes së një lloji ndaj kushteve të përgjithshme fiziko-gjeografike të një zone.* Kufinjtë e shtrirjes së llojeve varen gjithashtu dhe nga konkurrenca midis llojeve, kështu që areali potencial nuk është gjithmonë i njëjtë me atë real. Gjithashtu dhe njeriu ka ndikuar në përcaktimin e kufinjëve të shtrirjes të disa llojeve. Në vendin tonë bimësia shtrihet në pesë zona:

- **1. Zona e Dafinës (Lauretum)**
- **- temperatura mesatare vjetore 12-19°C**
  - rreshje mesatare vjetore 1200 mm
  - periudhë vegjetacioni 7-9 muaj.
- **Ka tre nënzona: e ngrohtë që shtrihet nga 200-300 m mbi nivelin e detit, nënzonën e mesme dhe të ftohtë që shtrihet midis 300-600 (800) m mbi nivelin e detit.**
- **Bimësia e zonës së dafinës ka kryesisht këto lloje shoqërimesh gjithmonë të blerta me karakter kserofil siç janë: dafina, xhixhibanozi, oleandri, fidhesi, lofata, valanidhi, prralli, ilqja, mareja, shqopa, xina, xana, mersina, frashëri, driza, bafra, shega e egër, mellagjeri, caraci, skërbulli, eukaliptet, manjola, pisha e butë, e egër, dëllinja e kuqe dhe kokërmadhe, palmat, agavja, fiku i indisë etj.**

- **2. Zona e gështenjës (Castanetum)**
  - temp mesatare vjetore 11-15^{0}C
  - rreshje mesatare vjetore 1650 mm
  - periudhë vegjetacioni 6-7 muaj.
- **Ka dy nënzona: atë të ngrohtë nga 600-800 (1000) m mbi nivelin e detit dhe nënzonën e ftohtë nga 1000-1200 m mbi nivelin e detit.**
- **Bimësia është: gështenja, bunga, shparthi, bungëbuta, qarri, arra, shkoza, mëlleza, verriu i zi, vidhi i fushës, lajthia, murrizat, gështenja e egër, blinjtë, frashëri, ashja, bushi, thana, panja fletgjërë, krekëza, shtogu, voshtra e rëndomtë, molla dhe dardha e egër, gorica, grathateli, kulumbria, cërmëdelli, urthi, shqemja, robinia, dëllinja e zezë, bërsheni, cedrat etj**

- **3. Zona e ahut (fagetum)**
  -temp mesatare vjetore 10-12^{0}C
  - rreshjet mesatare vjetore janë 1850-1950 mm
  - periudhë vegjetacioni 5-6 muaj.
- **Shtrihet nga 1200 - 1800 m mbi nivelin e detit dhe ka nënzonën e ngrohtë ku mbizotron pisha e zezë dhe nënzonën e ftohtë ku mbizotron ahu.**
- **Bimë të tjera karakteristike të zonës janë: bredhi, hartina, arneni, rrobulli, tisi, dëllenja e zezë, mështekna, vërrinjtë, shtogu i zi dhe i kuq, shelgjet, molla dhe dardha e egër, panja fletëgjerë dhe e malit, lajthia, vadheviçja, bushi, blinjtë, gështenja e egër, murrizat, ashja, boshtra, vidhi i malit, plepi i egër, ajdesi i alpeve etj.**

- **4. Zona e hormoqit (Picetum)**
  - Quhet dhe zona e rrobujve, formon më tepër një rrip të ngushtë mbi zonën e ahut që shtrihet ndërmjet 1700—2000 m mbi nivelin e detit.

- Temp mesatare vjetore është 6-11^{0}C
- rreshjet mesatare vjetore janë rreth 2100—2200 mm
- periudhë vegjetacioni 4-5 muaj.

- **Bimësia përfaqësohet nga hormoqi, rrobulli dhe arneni, pastaj kemi: hartina, bredhi, dëllinja e zezë, jermesina, mështekna, plep i egër, verriu i bardhë etj.**

- **5. Zona alpine (alpinetum)**
  - përfshin vendet e larta mbi zonën e hormoqit
  - temp mesatare vjetore < 6^{0}C
  - mbi 2100-2200 mm reshje vjetore
  - periudhë vegjetacioni < 4 muaj.

- **Bimësia e kësaj zone përbëhet nga kërleka, rrobulli, dëllinjat e ndryshme, shelgjet, trëndafilat e egër, fletëulliri dhe lloje të shumta barishtore që janë karakterisikë e kësaj zone.**

RENDI CONIFERALES

Abies Alba (Mill. 1768)– Bredhi i bardhë

Familja—Pinaceae

- **Nje pemë e gjatë e rrethuar nga një kurorë piramidale që bëhet e sheshtë sipër me kalimin e moshës. Drurë gjethembajtes, lulëzon vonë në pranverë.**
- **Arrin deri në 46m lartësi. Ka sistem rrënjor të thellë, boshtor. Kërcelli i drejtë, kurora e dendur cilindrike-piramidale. Lëvorja në moshë të re e lëmuar, degët të harkuara, halat me bisht të shkurtër deri në 3 cm, poshtë me dy vija paralele, lart të gjelbra të shndritëshme. Boçet cilindrike, të gjelbra në rini më pas të kuqërremta, nga dy të ngritura përpjetë.**
- **Është bimë monoike, vuan shumë në vitet e para të jetës. Është specie vendase e Evropës qëndrore e jugore, gjithashtu gjendet dhe në zonën e Azisë, malet Kaukaz. Preferon toka të lagështa në lartësi të mëdha.**
- **Bredhi i bardhë po të shihet nga poshtë duket sikur merr nje nuancë si në te argjentë, prandaj nganjëherë emërtohet dhe si " bredhi i argjentë ".**

Bredhi i maqedonisë – Abies borisii regis – Macedonian fir

Familja—Pinaceae

- **Është një dru përhereblertë që mund të arrijë lartësinë deri 60 m dhe me diametër deri në 2 m. Halat janë të gjata 2-3 cm me dy vija gojëzore nga poshtë, me ngjyrë të gjelbër të errët pjesa sipër. Boçet shumë të ngjashme me bredhin e bardhë por shpesh më të gjata, cilindrike deri konike, nga 10 – 21 cm të gjata.**
- **Areali i tij është Bullgaria, Greqia e Veriut, Shqipëria dhe ish vendet e Jugosllavisë. Shtrihet nga lartësia 600 m – 1800 m mbi nivelin e detit.**
- **Është dru i përmasave shumë të mëdha dhe në Bullgari gjendet dhe ekzemplari më gjatë i të gjitha specieve dhe ekzemplari më i vjetër rreth 170 vjeçar gjendet në Greqi në lartësinë 1350 m mbi nivelin e detit. Shumë studiues e përcaktojnë dhe si një hybrid ndërmjet bredhit të bardhë (Abies alba Mill.) dhe bredhit të greqisë (Abies cephalonica Loud.).**
- **Emrin latinisht e ka marrë për nder të carit Boris III, mbret i Bullgarisë.**

Picea Abies– Hormoqi

Familja—Pinaceae

- **Specie vendase europiane, është një halor gjithmonë i gjelbër dhe arrin lartësi 35-55m dhe diam. 1-1.5m. Sistemi rrënjor është tipik sipërfaqësor prandaj vuan nga rrëzimet e erës më shumë se çdo lloj tjetër drunor. Kërkon diellëzim të fuqishëm, toka me lagështi, drenazhim të mirë, preferon tokat acide. Ka rritje të shpejtë, formë konike të pemës.**
- **Halat 1-2.5cm të errta të gjelbra me një thumb shpues në majë. Boçet të gjata 9-17cm, me mëlluga gati trekëndore me majë, ngjyra e boçeve e gjelbër në rini dhe me moshën kthehen në kafe, më të mëdhatë tek bredhat. Ka nevojë për hapsirë që të zhvillohet, erëduruese, pemë që bën mjaft mirë hije. Është specia më tolerante ndaj faktorëve klimatik në gjininë e vet.**
- **Hormoqi është një nga speciet më të përhapura të bredhave dhe gjen përdorim si në në pylltari, lëndë druri, letër përdoret dhe si specie zbukuruese në parqe dhe kopshte, gjithashtu dhe në bonifikim sidomos në rehabilitim të minierave. Mund të përdoret dhe si pemë Krishtlindjesh. Pemë vendase e Evropës Juglindore, Norvegji, Siberi, Finlandë.**



Pinus Sylvestris - Hartina

Familja—Pinaceae

- Një pemë e gjatë deri 40m dhe me diam. deri 1- 2m. Ka sistem rrënjor skeletik. Trungu i drejtë (shtrembërohet vetëm nqs dëmtohet në rini). Kurora merr një sërë formash sidomos në popullatat e mëdha, për arsye të afërsisë.
- Lëvorja në pjesën e poshtme është e trashë dhe ka ritidom si në të argjentë, gri-kafe; në pjesën e sipërme dhe degë është e hollë dhe me ngjyrë portokalli-kuqe që është karakteristike e saj. Bisqet të gjelbër ne fillim, pastaj të hirtë. Halat me nga dy, të gjata 4-6cm të gjelbra ose të hinjta, të mprehta. Boçet 3-6 cm, vezake, të zbehta, të verdha-kafe, me bisht të shkurtër, hapen kur piqen, me mëlluga me një majë të vogël.
- Preferon toka acide, toleron tokat jopjellore, tokat e thata. Është pemë vendase e Evropës dhe Azisë. Është pema kombëtare e Skocisë. Hartina përshtatet mirë si brez mbrojtës në det, pemë dekorative, duron ndotjen. Është e vetmja pemë vendase e Evropës së Veriut.

Pinus Nigra - Pisha e zezë

Familja—Pinaceae

- Pemë halore, është pemë vendase e Evropës Jugore deri në Azinë e Vogël dhe në Afrikën Veriore. Gjendet në një lartësi deri në 2000m mbi nivelin e detit. Pemë e lartë 20-55 m.
- Ka sistem rrënjor anësor. Lëvorja është e hinjtë deri e verdhë-kafe me plasaritje të theksuara me kalimin e moshës. Kurora vezake-piramidale me kalimin e kohës duket si e shtypur. Bisqet të zhvilluar, ai skajor rritet deri në 70 cm në vit, sythat të mëdhenj, rrëshinor. Halat me nga dy sëbashku të gjelbra të errta dhe 8-20 cm të gjata, të grumbulluara në majën e biskut, të forta, me majë shpuese. Boçet me nga dy sëbashku, simetrike, vezake deri vezake-konike, arrijnë 5-10 cm gjatësi dhe kalojnë nga jeshile në të verdhërreme. Vendase e Mesdheut.
- Si specie ka një rritje të shpejtë 30-70 cm në vit dhe zakonisht ka një formë të konike në të rrumbullakët dhe që bëhet e çrregullt me kalimin e moshës. Ka relativisht jetëgjatësi të madhe, disa arrijnë në mbi 500 vjet. Nuk duron hijëzim pra kërkon diell por është rrezistente ndaj borës dhe ngricave apo thatësirës. Sipas zonës ndahet në nënspecie.



Pinus Heldreichii - Rrobulli

Familja—Pinaceae

- Lartësia 20(30) m, por shpesh dhe si shkurre, forma piramidale në ovale. Sistem rrënjor boshtor. Të degëzuar. Lëvorja e trashë, e copëzuar në pllaka të mëdha.
- Degët të përdredhura me tendencë për lart, bisqet në fillim të bardhërremë që më pas kthehen në kafe në fund të vitit të parë. Halat me nga dy sëbashku, 6-11cm të gjata, të forta, me majë, të gjelbra. Sythat ngjyrë kafe. Boçet në grumbuj me nga 2-4 së bashku me vriguj të vegjël, të gjata 7-9 cm dhe 2.5cm të gjëra, hapen kur piqen, me bisht shumë të shkurtër ose pa.
- Është pishë endemike e Shqipërisë. Mbillet në zonat e eroduara.



Pinus halepensis- pisha e egër (pisha e Alepit)

Familja—Pinaceae

- Është pishë vendase e rajonit mesdhetar. Rrezja e shtrirjes është nga Maroku në Spanjë dhe deri në Jordani e Izrael. Gjendet zakonisht në lartësi 200 m mbi nivelin e detit, por ka raste që në disa vende rritet dhe në lartësi mbi 1000 m apo 1700 m në jug të Marokut dhe Algjeri.
- Ka një madhësi mesatare që arrin deri në 15-25 m me një diametër trungu 60 cm. Lëvorja është portokalli-kuqe , e trashë dhe me të çara në bazë dhe e hollë e plasaritur në pjesën e sipërme, kërcelli i shtrembër, ka shumë rrëshirë. Kurora e rrallë, e çrregullt. Halat të holla, 6-12 cm, të verdhërreme-jeshile me nga dy bashkë(rrallë me nga tre), tepër të imta, të grupuara në majë të bisqeve si furçë. Boçja e ngushtë konike, 5-12 cm të gjata e 2-3 cm të gjëra, të vetmuara ose nga dy, të gjelbra në fillim, kur piqen të shkëlqyera, të kuqe-kafe.
- Ka kërkesa të pakta toke përshtatet kudo, rritet shpejt. Përdoret për lëndë drusore në disa vende, si pemë dekorative për parqe etj. Rrëshira e saj përdoret si aromatizues për një lloj vere greke.

Pinus pinea- pisha e butë

Familja—Pinaceae

- Vendase e Evropës Jugore dhe e Mesdheut. Kjo pemë është shfrytëzuar që në lashtësi prej farave të saj të ngrënshme.
- Arrin lartësinë deri 25m megjithëse zakonisht është më pak e gjatë, rreth 12-20m. Ka një formë karakteristike si çadër, me trung të shkurtër dhe të gjërë, kurorë gati rrumbullake. Lëvorja është e trashë, e kuqe-kafe dhe me të çara të thella në drejtim vertikal. Halat me nga dy sëbashku rrallë me tre, 10-20cm të gjata. Pemët e reja rrisin hala të reja që janë ndryshe, të vetmuara (jo dyshe),2-4cm të gjata, të blerta në të kaltër. Boçet të gjëra-vezake, 8-15cm të gjata dhe duan 36 muaj që të piqen, më gjatë se çdo lloj pishe tjetër, të vetmuara ose nga dy sëbashku, me ngjyrë të murrme të kuqërremtë. Farat të mëdha, 2cm të gjata, kafe të çelura, me një shtresë të hollë të zezë që hiqet kollaj. Farat shpërndahen nga kafshët dhe prej njerëzve. Lulëzon herët në pranverë.
- Nuk ka kërkesa të mëdha toke, mbillet në ranishte bregdetare. Ka të paktën 6000 vjet që kultivohet prej farave të ngrënëshme (fistiku). Mbillet dhe për shkak të hijëzimit të fuqishëm që ofron.



Pinus radiata - Pisha radiate

Familja—Pinaceae

- Arrin gjatësinë 15-35 m, me degët të drejtuara për lart dhe në majë gati e rrumbullakosur. Rritet shpejt. Ka rrënjëzim anësor të fuqishëm dhe jo të thellë. Lëvorja ka të çara të çrregullta dhe kanale të ashpra, gjatësore, e zezë në gri-kafe.
- Halat të dendura, të gjelbra të shndritshme, me nga tre sëbashku, të holla, 8-15cm, me majë të butë . Boçet 7-17cm të gjata, kafe, vezake, të vetmuara, të vendosura në mënyrë asimetrike në degë. Lulëzon herët në pranverë. Është dru monoik.
- Ka prejardhje nga rajoni i Kalifornisë dhe është pisha më pak e kërcënuar nga të gjitha. Në zona urbane mund të mbillet përgjatë bregdetit. Sapo arrin të instalohet, bëhet mjaft e qëndrueshme ndaj thatësirës. Ka rritje të shpejtë dhe mund të krahasohet me plepat apo eukaliptet dhe ka kërkesa të larta ndaj tokës dhe dritës.



Pinus peuce - Arneni
Familja—Pinaceae

- Është specie vendase e maleve të Maqedonisë, Bullgarisë, Shqipërisë, Serbisë dhe pjesës veriore të Greqisë. Rritet në lartësi (600) 1,000-2,200 (2,300) m mbi nivelin e detit dhe shpesh arrin lartësinë e zonës alpine. Kur arrin pjekurinë trungu arrin 35-50 m lartësi dhe 1.5m diametër. Ka rritje të avashtë.
- Ka sistem rrënjor shumë të zhvilluar, qëndrueshmëri ndaj erërave. Kurora e rregullt, konike e rrumbullakosur. Halat i ka nga pesë , të gjata 6-11 cm. Boçet janë zakonisht 8-16cm të gjata, rrallë 20cm, skajore, me bisht të shkurtër, të varura, me ngjyrë të murrme në të gështenjtë. Lulëzon në fillim vere.
- Është rrezistente ndaj dëmtuesve. Arneni është dhe një specie dekoruese e parqeve. Është rrezistente ndaj dimrave të acartë dhe temperaturave deri –45^0 C, gjithashtu dhe ndaj erërave të fuqishme. Preferon toka pjellore, të drenazhuara mirë, nuk duron përmbytjet.



Thuja orientalis– Tuja e lindjes
Familja—Cupresaceae

- Dru halor ose shkurre përherë i gjelbër, nuk i kalon 12 m. Lëvorja e drurit e hollë e kuqërreme.
- Degët dhe bisqet të ngritura përpjetë. Specie me prejardhje nga Kina veri-perëndimore. Është një pemë e vogël dhe me rritje të avashtë. Gjethet i ka të vogla 2-4mm të gjata. Boçet vezake mishtake, të rimta, me 6-8 mëlluga me thumb të gjatë, 15-25mm, të gjelbra , kur piqen ngjyrë kafe.
- Dallohet nga tujat e tjera për shkak se ka degëza gjethore shumë të vogla në rrafshe vertikale. Përdoret si pemë dekorative për parqe dhe për kopshte. Në vendin e origjinës njihet dhe si druri me jetëgjatësi të madhe, mbillet ne tempujt budist.

Cupressus sempervirens - Selvia (Qiparisi)
Familja—Cupresaceae

- Pema arrin lartësi 20-30m, trungu i drejtë. Kërcelli i drejtë cilindrik. Lëvorja e hollë, e lëmuar dhe ngjyrë gri për një kohë relativisht të gjatë, më vonë kthehet në kafe-gri dhe pëson rrudhosje në formë vertikale.
- Bisqet përhapen në të gjitha drejtimet, gjethet janë mëllugore të sheshta, të vogla, të gjelbra-të errta. Lulet shfaqen në fillim të pranverës. Boçet në trajtë goglash, me bisht të shkurtër, me shkëlqim,kafe në gri, të varura,të rrumbullakta– eliptike, 2-3cm të gjata , të përbëra nga 8-20 mëlluga dhe me një thumb qëndror, boçet rrijnë në pemë për disa vjet. Për shkak të historikut të gjatë në Mesdhe, origjina e saj është disi e paqartë. Disa autoritete mendojnë se ka prejardhje nga Greqia, Turqia,Iran,Qipro por dhe në Tunizi e Libi.
- Duron temp. deri -20^{0}C, thatësirën, rrymat e ajrit. Ka sistem rrënjor të fuqishëm. Mostra më e famshme gjendet në Greqi (Lefka Ori). Selvia jeton më tepër se 1000 vjet. Është një specie ornamentale në të gjithë botën, druri është i fortë dhe përpunohet lehtë. Mund të përdoret si lloj mbrojtës ndaj erërave ose në hijëzimin e rrugëve.

Juniperus communis – Dëllinja e zezë
Familja—Cupresaceae

- **Shkurre ose dru deri ne 10 m, dru i fortë i ngjeshur aromatik me kokrriza të imëta. Sistemi rrënjor është sipërfaqësor. Dru i fortë, i ngjeshur, aromatik.**
- **Kërcelli fillon të degëzohet që në afërsi të tokës. Bisqet me seksion trekëndor. Gjethe janë hala të forta dhe shpuese, pa bisht, në qerthuj me nga tre, me ngjyrë të gjelbër-të rimtë, në faqen e sipërme kanë një kanal me një vijë gojëzore të bardhërreme, poshtë është e gjelbër me karene. Gjethet janë të gjata 10-15 mm dhe ndërrohen çdo vit. Është bimë dioike Ka rritje shumë të ngadaltë. Fruti rrushk i rremë ngjyrë të gjelbër më pas të zezë të kaltër me një pluhurizë dylli.**
- **Është e përhapur në të gjithë hemisferën veriore. Druri i dëllinjës përdoret për prodhimin e pijes së famshme xhin dhe në industrinë farmaceutike e të parfumeve.**



Juniperus Oxycedrus– Dëllinja e kuqe
Familja—Cupresaceae

- **Shkurre 8-9 m e lartë. Dallohet nga dëllinja e zezë prej boceve më të mëdha, që janë 6-12 mm dhe me ngjyrë të kuqërreme në pjekuri.**
- **Halat në faqen e poshtme kanë karene të mprehta ndryshe nga dëllinja e zezë qe i ka shyte dhe janë të paisura me dy vija gojëzore në vend të një qe ka dëllinja e zezë.**
- **Tek ne takohet kryesisht në zonën e dafinës dhe të gështenjës. Fruti mund të përdoret për nxjerrjen e alkolit.**



Juniperus Macrocarpa - Dëllinja kokërrmadhe
Familja—Cupresaceae

- **Karakteristikë dalluese nga dëllinja e kuqe është përmasa e frutit, që është më i madh deri 8– 15 mm me një pluhurizë të dendur dhe nga halat më të gjata deri 30 mm dhe më pak të thyeshme. Më tepër ka trajtë shkurreje por mund të arrijë dhe lartësi deri në 10 m, trung gjithmonë të ndarë që në bazë.**
- **Ka rritje të ngadaltë dhe fuqi mbirëse të pakët. Tek ne takohet përgjatë bregdetit në sajë të rrezistencës së saj ndaj kripës dhe aftësisë për tu vendosur në duna.**

JUNIPERUS SABINA - *JERMESINA*

Familja—Cupresaceae

- **Specie vendase Europës dhe e Azisë perëndimore. Gjithmonë e gjelbër.**
- **Shkurre zvarritëse, degët ngrihen për lart ose me dru të vogël. Degët të drejta, bisqet e holla. Gjethet mëllugore të ngjeshura pas biskut.**
- **Fruti rrushk i rremë, i kaltër i errët, vezak-rruzullor. Transportohet lehtë, preferon tokat e lagura dhe diellin. Përdoret si pemë zbukuruese në parqe dhe kopshte. Të gjitha pjesët e bimës janë helmuese, kjo për shkak të disa përbërsëve helmues.**

Juniperus Phoenichea - *Fidhesi*

Familja—Cupresaceae

- **Shkurre dhe rrallë si dru, 6-8 m lartësi. Lëvorja fibroze e ngjashme me atë të selvisë, por që shkëputet në rripa të hollë në formë spiraleje.**
- **Gjethet mëllugore, me majë shyte, me buzë të dhëmbëzuara imët, që kanë një thellim gjëndor nga ana e poshtme. Frutat janë rrushqe të rremë, piqen një herë në dy vjet, me ngjyrë të kuqe pa pluhurizë.**
- **Tek ne në përgjithësi takohet përgjatë bregdetit.**

Juniperus foetidissima– Bersheni

Familja—Cupresaceae

- **Pemë vendase e Evropës jugperëndimore dhe Azisë jugperëndimore , që nga pjesa jugore e Shqipërisë dhe veriu i Greqisë deri në Azinë e largët.**
- **Pemë me lartësi mesatare 6-25 m me kurorë konike ose të çrregullt. Gjethet e reja si hala 8-10mm dhe kur rriten në trajtë mëllugore 2-3mm. Boçet janë me ngjyrë të kuqe, 7-13 mm në lulëzim të kaltra-të zinj. Shfaqet shpesh me Juniperus exelsa por dallohet nga ajo prej bisqeve më të trashë. Gjethet kanë një aromë të fortë, jo të mirë. Është lloj dioik.**
- **Disa mostra janë të mbrojtura posaçërisht në Turqi, ku një specie vlerësohet të jetë 1700 vjeçare (Luani i dëllenjtë, 25 m i gjatë).**



Taxus Baccata - Tisi
Familja—Taxaceae

- **Dru i vogël me lartësi 10-15 m por shpesh dhe si shkurre, kërcelli i drejtë me kanale, lëvorja e hinjtë në të kuqërreme dhe rripet në pllaka.**
- **Sythat të grumbulluara në majë të bisqeve, vezak të gjelbër sikurse dhe bisqet. Gjethet vezake 10-35 mm, pak koserake të buta, të mprehta por jo gjembore, të gjelbra të errëta sipër dhe poshtë ngjyrë të hapur. Fruti boçe në trajtë bërthokle me një farë vezake, brenda një pështjellëse mishtake të kuqe të ëmbël.**
- **Rritet shumë ngadalë por jeton mjaft gjatë 2000-3000 vjet. Është lloj hijedashës. Tek ne takohet pak në formë të ekzemplarëve të vetmuar ose në grupe të vegjël.**

Nëndega e bimëve farëveshura (Angiospermët)

Nga pikëpamja filogjenetike këto bimë janë më të reja sesa gjimnospermët. Gjini të rëndësishme për vendit tonë janë: Fagus, Quercus, Salix, Carpinus, Fraxinus, Tilia, Acer, Betula, Populus, Juglans, Ulmus etj. Bimët drunore farëveshura përfaqësojnë një numër më të madh sesa ato farëzhveshura. Karakteristike e tyre është prania e një mbështjellëse lulore që mund të jetë e thjeshtë ose e dyfishtë. Lulet janë tepër të ndryshme si strukturë, formë, ngjyrë, përmasa, qëndrojnë në lulesa të gupuara ose janë të veçuara. Frutat gjithashtu janë të larmishëm, mishtakë, të thatë, çahës, jo çahës në pjekuri etj. Druri ka një strukturë komplekse me gypa të përsosur, nuk përmbajnë kanale rrëshire. Areali i farëveshurave shtrihet në të dy hemisferat si dhe në zonën ekuatoriale, tropikale dhe subtropikale. Kanë aftësi të madhe ripërtëritje si në rrugë seksuale me farë, vegjetative me lastarë apo kalema, pinjolla, shartesa.

Angiospermët ndahen në dy klasa në varësi të kotiledoneve:

1. **Dicotyledoneae**
2. **Monocotyledoneae**

Ku të parat janë bimë me gjethe të thjeshta ose të përbëra. Embrioni ka dy kotiledone (Gjethe embrionale). Në këtë klasë bëjnë pjesë shumica e llojeve fletorë. Ndërsa tek klasa mokotiledone përmbledhin bimët barishtore, rrallë drunore, me një kotiledon, nuk kanë kambium dhe rrathë vjetorë, gjethet i kanë të thjeshta. Nga bimët e pakta drunore monokotiledone shumica janë tropikale: Bambuja (Arundinaria), Banania (Musa), Palmat (Chamaerops). Llojet drunore indigjene janë vetëm ata të gjinisë Ruscus, të rendit Liliales.

Salix Babilonica L - Shelgu vajtues
Familja—Salicaceae

- **Dru gjethe rënës. Lartësia deri 20 m, ka rritje të shpejtë dhe jeton mesatarisht pak vite. Degët e sidomos bisqet i ka shumë të gjatë, të verdhërremë, të shogët e të shndritshëm të varur poshtë që mund të arrijnë deri në tokë (duket sikur vajton).**
- **Gjethet të shogëta, të ngushta heshtake, të gjata 8 - 15 cm dhe nga poshtë janë të gjelbra të hinjta. Dru dioik, ku lulet prodhojnë push në ekzemplarë të veçuar. Fruti kapsulë 1cm, që përmban shumë fara të pambukta.**
- **Dru vendas i Kinës veriore. Emri salix mund të ketë kuptim nga gjuha Kelte ku "sal" dmth afer dhe "lis" dmth ujë. Emri babilonica është një keqkuptim i Linnaeus pasi kjo specie është ajo që përshkruhet në bibël në zonën e Babilonisë. Mbillet kryesisht në zona me lagështi, kryesisht afër liqeneve ose burimeve të ujit ku format e tyre mund të reflektohen. Duhet patur kujdes pasi rrënjët e tyre mund të krijojnë dëme në infrastrukturë. Duron kushte bregdetare. Tërheq mjaft insekte përfshirë dhe bletë që e polenizojnë këtë specie. Preferon toka me lagështi, të thella. Toleron periudha të gjata përmbytje dhe thatësira të zgjatura. Kërkon pak mirëmbajtje.**

Salix Caprea - *Shelgu i egër*
Familja—Salicaceae

- **Shkurre (dru) 8-9 m, gjetherënësë, kërcell të shtrembër, lëvorja e lëmuar e hinjtë e gjelbër në fillim, më vonë me një ritidom të hollë i plasaritur çrregullt.**
- **Bisqet dhe degët janë të shogëta, bisqet janë ngjyrë të kuqërreme ose të gjelbër të verdhërreme. Sythat vezakë vezakë konikë të shtypur, të murrmë të kuqerreme, në fillim me push pastaj të shogët. Gjethet me bisht deri 2 cm të shogëta eliptike të gjera, me push të bardhë nga poshtë, të trasha e pak të përkulura, me nervatura shumë të dukshme. Kapsollat me bisht të gjatë dhe me push. Dru dioik, tek bima mashkull me push gri dhe verdhërreme ndërsa tek bima femër pushi më ngjyrë jeshile të hapur.**
- **Vendase e Evropës. Përdoret gjërësisht si bimë dekorative si pjesë e e skemave të gjelbërimit natyror, sidomos në vendet me shume lagështi. Shelgu i egër preferon lagështi të shumtë, humus të pasur. Tolerant si ndaj përmbytjeve dhe thatësirave. Nuk kërkon krasitje të shpeshta, nqs ka degë të dëmtuara duhen hequr, vonë në vjeshtë.**

Salix Purpurea - *Shelgu i kuq*
Familja—Salicaceae

- **Arrin deri 4 m, bisqet të hollë, elastik, të kuq të purpurt ose të verdhë. Sythat të zgjatura, të kuqe të murrme, të vendosura në mënyrë të crregullt, shpesh të perkundrejtë. Gjethet të përkundrejta, vezake të përmbysura deri heshtake ose vezake 5–10 cm, të mprehta, me buzë të sharruara imët vetëm në gjysëm dhe të vendosura paralelisht dhe jo të alternuara. Lulet i ka të vogla me push që zhvillohen herët në pranverë.**
- **Dru gjetherënës, është me orgjinë Evropiane dhe Azia perëndimore.**

Salix Amplexicaulis - *Shelgu kërcellpështjellës*
Familja—Salicaceae

- **Arrin lartësi deri 5– 6 m, gjethet i ka heshtake të përkundrejta me buzë gati paralele dhe të dhëmbëzuara, me gjëndra në tërë gjatësinë e gjethes, në formë zemre në bazë, pa bisht, gjysëm të pështjella pas biskut. Lulet në trajtë lëvaresh me thekë të ngjitura midis tyre.**
- **Është lloj i përhapur në gadishullin Ballkanik. Tek ne takohet kudo në luginat e Shqipërisë së Mesme dhe ngjitet deri në lartësinë 1800 m mbi nivelin e detit. Për nga kërkesat ngjason me shelgun e kuq që shoqërohet por dhe ngatërrohet me të.**

Salix Fragilis - *Shelgu i thyeshëm*

Familja—Salicaceae

- **Mund të arrijë deri 15 m lartësi, ka kërcell të drejtë e lëvore ngjyrë gri, bisqet relativisht të trashë, të gjelbër, të shogët, të shndritshëm, shumë të thyeshëm në vendin e daljes nga dega. Sythat janë të murrme të hapët në bazë dhe të zezërremë në majë. Gjethet me bisht 2 cm, të shogëta, me dy gjëndra të dukshme në bazën e gjethes, me llapën heshtake 6 - 17 cm, pykore ose të rrumbullakosura në bazë, më buzë të sharruara imët. Lulet në levare me dy thekë dhe me pjalmore të verdha. Kapsollat me push dhe me bisht të gjatë.**
- **Është lloj pionier me kërkesa të pakta ndaj klimës, mund të rritet në toka të thata dhe kënetore. Është i përhapur gjerësisht në Evropë dhe Azi. Tek ne gjendet deri në lartësinë 1700 – 1800 m mbi nivelin e detit. Ka përdorime të shumta druri dhe lëvorja e tij.**

Salix Elaeangos L- *Shelgu i butë*

Familja—Salicaceae

- **Arrin lartësi deri 6 m, ka kërcell të dukshëm dhe me degë të shkurtëra, të holla, të ngritura përpjetë e të thyeshme. Bisqet e rinj me push, më vonë të shogët, të murrmë të verdhërremë. Gjethet vizake heshtake, të gjata 4 - 11 cm, me majë të gjatë e të thepët dhe me dy buzë paralele, të përthyeshme, afër majës të sharruara imët. Lulet në levare cilindrike deri në 5 cm. Lulëzon vonë në pranverë – verë.**

- **Shkurre vendase e Evropës dhe Azisë jug perëndimore. Përdoret për mbjellje në zona urbane ngaqë kërkon pak mirëmbajtje dhe është shumë tërheqëse. Ajo është tolerante ndaj ndaj kushteve të ndryshme të tokave por preferon tokat acide ose neutrale dhe duron thatësirat. Duron krasitje të shumtë, nqs është e zhvilluar shumë krasitja bëhet në dimër.**

Salix Alba L - *Shelgu i bardhë*

Familja—Salicaceae

- **Arrin lartësi deri 15 m dhe rrallë deri 25 m. Dallohet nga aftësia që ka për të formuar rrënjë ajrore. Kërcell të drejtë, lëvorja e hinjtë më të cara të thella. Bisqet të epshëm të hollë të gjelbër të verdhërremë. Sythat të zgjatura të verdhërreme të kuqërreme të ngjitura pas biskut. Gjethet me bisht të shkurtër deri 1 cm, pa gjendra me ndajgjetheza të ngushta e të rrënëshme , me llapë heshtake të thepët 5 - 10 cm të gjata, buzët të sharruara imët, në fillim me push të mëndafshtë në ngjyrë të argjendë në të dy faqet, ndërsa në pjekuri vetëm në anën e poshtme ose gjatë nervaturës së mesit. Fruti kapsulë e shogët pothuajse pa bisht. Ka një fuqi të madhe lastarizimi. Lulëzon në pranverë. Dru dioik. Rrënjët nuk i shkojnë shumë në thellësi por janë shumë të zhvilluara anash.**

- **Dru vendas i Evropës dhe i Azisë perëndimore – qëndrore. Përdoret shumë në thurjen e shportave dhe materialeve sportive me dru. Emrin alba e ka marrë prej anës së poshtme të gjetheve më të zbardhura. Mund të mbillet në vende me hapsirë (distancë nga infrastruktura) dhe me lagështi. Pranon shumë krasitjen që bëhet në periudhën e pranverës para gjethëzimit. Mund të përdoret dhe si frenues i erërave. Kujdes duhet patur sepse rrënjët mund të dëmtojnë objektet në afërsi. Duron mirë dhe kushtet bregdetare. Preferon tokat me lagështi, të thella, toleron përmbytjet dhe nuk pëlqen periudhat e gjata të thatësirës.**

Salix viminalis L – Shelgu industrial
Familja Salicaceae

- **Shkurre deri 6 m. Ka bisqe të gjatë të drejtuara përpjetë, të gjelbërremë ose të verdhërremë. Sythat dy herë më të gjatë se të gjërë. Gjethet vizake heshtake deri 15 cm të gjata, me buzë të plota, nga poshtë të shndritëshme, me nervaturën e mesit të dalë dhe të verdhëreme.**
- **Është lloj euroaziatik, kryesisht në grykëderdhjet e lumenjëve. Tek ne i kultivuar dikur për prodhim thuprash, qëllime zbukurimi etj,**

Populus Alba L - Plepi i bardhë
Familja—Salicaceae

- **Arrin lartësi 30-35 m, ka kërcell në fillim pak të shtrembër, pastaj të drejtë, cilindrik i trshë dhe shumë i degëzuar. Lëvorja karakteristike e bardhë dhe e lëmuar në rini, më pas formon një ritidom të fortë e të shpër sidomos në bazë, me të çara të thella e ngjyrë të errët. Bisqet vjetorë dhe sythat e rinj të mbushur me push. Gjethet me bisht të gjatë, vezake të rrumbullakëta me 3-5 vriguj pëllëmborë, me majë të mprehtë, të cungëta deri pothuaj si zemër në bazë, me push të bardhë nga poshtë. Gjethet që dalin nga bisqet e shkurtër janë më të vogla, vezake deri gjatore, me buzë vetëm gjirake të dhëmbëzuara, të rralla dhe me qerpikë të gjatë. Kapsollat piqen herët, ndërsa farat e vogla kanë tufa qimesh të gjata, të bardhërreme që ngjajnë me pambukun, përhapen menjëherë.**
- **Ka sistem rrënjor të fuqishëm, me rrënjë anësore të fuqishme. Ka rritje të shpejtë, është lloj dritëdashës, riprodhohet në mënyrë vegjetative. Ndër plepat është lloji me kërkesa më të mëdha ndaj tokës siç janë të thella, aluvionale, pjellore etj. Tek ne gjendet deri në lartësinë 1200 m mbi nivelin e detit. Druri i tij përdoret në prodhimin e ambalazheve dhe sidomos të letrës. Tek ne gjendet në zonënë e Lauretum dhe Castanetum.**



Populus tremula L - Plepi i egër
Familja—Salicaceae

- **Arrin lartësi 20-25 m rrallë deri 35 m, kërcell të drejtë, në pjesën më të madhe të zhveshur nga degët. Lëvorja e lëmuar si e plepit të bardhë, e bardhërreme me nuance karakteristike të gjelbra, në pjesën e poshtme të kërcellit dhe në moshë të madhe ajo trashet, plasaritet lehtë dhe merr ngjyrë në të zezë. Bisqet të shogët me qime të rralla të murrme të kuqërreme me majë të mprehtë. Sythat të afruara pas biskut shumë të shndritshëm, me 3-4 mëlluga. Gjethet e bisqeve të shkurtëra, të vogla 3 – 8 cm dhe gati rrumbullake, të holla të cungëta ose si zemër në bazë, me buzë gjirake dhe të dhëmbëzuara ura ura, me majë të rrumbullakosur, te shogëta në të dy faqet me bisht 3-6 cm dhe e lëviz llapën kur fryn erë. Gjethet e lastarëve janë më të mëdha. Fruti është një kapsulë.**
- **Tolerant ndaj dimrave të ftohtë dhe verës së shkurtër. Shumë pak kërkues ndaj kushteve të tokës. Ripërtërihet vegjetativisht me pinjolla ose kalema. I përhapur gjerësisht në Evropë, Azi, Afrikë Veriore. Tek ne gjendet deri në 1800 m mbi nivelin e detit në zonën e Ahut dhe Hormoqit. Përdoret dhe si specie pionier.**

Populus Nigra L - *Plepi i zi*

Familja—Salicaceae

- Arrin lartësi 20 - 30 m dhe rrallë deri 40 m, kërcell i drejtë në disa raste i çrregullt, që në moshë të re formon një lëvore të zezë-gri me çarje të thella gjatësore. Rënjët i ka të shtrira shumë anash – sipërfaqësore. Lëvorja e lëmuar. Është dru gjetherënës. Bisqet të lëmuar, të shogët, cilindrikë të verdhërreme ose gri të gjelbër. Sythat viskozë 1-2 cm të verdhë të gjelbërremë konikë të mprehtë. Gjethet e bisqeve me bisht 2-8 cm, trekëndore ose rombike 5-7 x 2-5 cm të gjelbra të shndritëshme, me majë të mprehtë e me formë pykore në bazë me buzë të dhëmbëzuara, të lëmuara të shogëta, me nervatura të dukëshme në faqen e poshtme. Në rini gjethet në ngjyrë të bronztë dhe të verdha para se të bien. Dru dioik dhe lulet polenizohen me anë të erës.
- Fruti kapsulë 7-9 mm, e gjatë e shogët, vezake e drejtë dhe me bisht, jeshile. Në zonën e ballkanit është futur për herë të parë gjatë periudhës otomane.
- Dru vendas i Evropës dhe Azisë perëndimore- qëndrore, Afrikës veri-perëndimore. Emrin Populus e merr nga latinishtja (pema e popullit). Mbillet si pemë e peizazhit natyror, në zona me shumë ujë. Tek ne gjendet deri në 1200 m mbi nivelin e detit. Kujdes duhet në vendosjen në distancë pasi rrënjët shkaktojnë dëme në godina dhe sisteme nëntoksore etj. Preferon toka pjellore, me lagështi. Kërkon mirëmbajtje të pakët. Duhet patur parasysh se është pemë që krijon alergji në periudhën e shumimit.

Populus Nigra L. var (Italica) - *Plepi i kavak*

Familja—Salicaceae

- Lartësia rreth 25 m. Origjina nga Lombardia e Italisë. Dallimi nga plepi i zi është nga forma karakteristike piramidale, lëvorja e hinjtë e zerzërrëme, me të çara të thella. Bisqet dhe degët të ngritura përpjetë, të holla, dhe formojnë një kurorë të ngushtë si kolonë. Gjethet më të vogla, rombike. Levaret gjithashtu më të vegjël. Mund të shumëzohet me kalema dhe lastarë. Gjendet kudo në Shqipëri deri në lartësinë 700 – 1000 m mbi nivelin e detit.
- Vlerësohet si lloj dekorativ në parqe buzë rrugëve, sidomos kur janë të mbjellë në linja të drejta. Kanë efekt mbrojtës nga erërat por ka dhe mundësi të rrëzohen nga erërat e forta. Rrënjët gjithashtu mund të dëmtojnë ndërtesat dhe infrastrukturën. Përshtatet me të gjitha tokat por preferon tokat gëlqerore.

Forma mbjelljeje urbane

Juglans regia – *Arra*

Familja Juglandaceae

- Lartësia arrin 15-20 m dhe ka kërcell të drejtë cilindrik. Lëvorja për shumë kohë është e lëmuar me ngjyrë argjendi-e hinjtë, ndërsa në moshë të madhe plasaritet në mënyrë gjatësore. Ka sistem rrënjor boshtor të fuqishëm dhe rrënjë anësore që shtrihen në distanca të mëdha.
- Bisqet të trashë të shogët, të murrmë të shndritshëm, sythat rruzullore me mëlluga të zeza, të shogët. Gjethet tekpendore të përbëra deri 35 cm të gjata me 5-9 gjethëza të përkundrejta eliptike, asimetrike, me buzë të plota, të lëkurta. Fruti bërthokël rruzullore me zhguall, i ngrënshëm. është bimë monoike, lulet në levare që dalin në pranverë. Shumëzohet me farë dhe lastarizon fuqishëm.
- Kërkon klimë të butë, pa ngrica të mëdha, kërkues ndaj tokës, pak e shoqërueshme me llojet e tjera. Origjinën e ka nga Azia. Tek ne takohet deri në lartësinë 1200 m lartësi mbi nivelin e detit. Ndryshon nga rajoni në rajon, emrin regia dmth mbretëror. Mund të mbillet në qytete vetëm kur kemi hapsira të bollshme. Mund të krasitet në verë deri në vjeshtë sa është akoma gjethëzimi. Përdoren frutat si ushqim dhe druri është ndër më të bukurit për rimeso gjithashtu dhe rrënjët e tij përdoren për rimeso.



Alnus glutinosa L- *Vërriu i zi*

Familja Betulaceae

- **Lartësia arrin 20-25 m dhe ka rrënjëzim sipërfaqesor – boshtor. Rrënjëzat formojnë disa gunga ngjyrë portokalli ku jetojnë baktere azot fiksuese. Kërcelli i drejtë deri në majë, lëvorja e lëmuar, e shndritëshme, kurora e dendur. Bisqet të epshëm të hollë, në majë me qoshe. Gjethet të thjeshta, të këmbyera, vezake të përmbysura ose afërsisht të rrumbullakëta 4-10 cm, pykore në bazë, të gjelbra të shndritëshme, me një bishtak 2-3cm. Bimë monoike me lule me levare, mashkulloret në vile, cilindrike 6-12 cm nga 3-5 sëbashku, femëroret vezake gjatore 1-5 cm, në pjekuri transformohen në boçe vezake elipsoidale. Lulëzon në pranverë. Preferon tokat me lagështi, buzë përrenjëve.**

- **Durojnë mjaft mirë ndotjen urbane, përdoret si mbjellje në skemat me bimësi vendase. Kërkon pak mirëmbajtje. Emrin alnus e ka nga latinishtja dhe glutinosa i referohet gjetheve ngjitëse. Dallohet për aftësinë e madhe të ripërtëritjes vegjetative. Klima nuk përbën faktor kufizues për përhapjen e tij, ndërkohë që është shumë kërkues ndaj faktorëve edafik si lagështia e tokës. është i përhapur në të gjithë Evropën, Azinë e Vogël, Afrikën Veriore. Prodhohet dhe qymyr druri.**



Alnus incana - *Vërriu i bardhë*

Familja Betulaceae

- **Shkurre dhe rrallë si dru 8-10 (20) m e lartë. Lëvorja gjithmonë e lëmuar dhe e shndritëshme. Bisqet me push, pa qoshe dhe jo ngjitëse. Sythat me dy mëlluga, pak të larguara nga bisku, me bisht të shkurtër.**
- **Gjethet të thjeshta të përkundrejta, me bishtak 3 cm, vezake, vezake-eliptike, të rrumbullakosura ose pykore në bazë, dyfish të dhëmbëzuara e të mprehta, sipër të shogëta, poshtë me push hiri. Lulet në levare si të vërriut të zi. Boçet vezake, me mëlluga të drunjëzuara, ngjyrë kafe me flatra të ngushta.**
- **Sistem rrënjor shumë sipërfaqësor. është bimë monoike. Ka rritje të shpejtë, përshtatet me klimat e ftohta, vegjeton si lloj pionier. Kryesisht shtrihet në Evropën qëndrore dhe gadishullin Skandinav. Tek ne takohet buzë përrenjëve nga 1000 – 1800 m mbi nivelin e detit. Përmirëson tokat nëpërmjet lëgushës së tij të pasur me azot. Përdoret për stabilizimin e terreneve të degraduara, shpateve të pjerrët.**



Carpinus betulus - *Shkoza e bardhë*

Familja Betulaceae

- **Arrin lartësi 10-12 m ka kërcell të drejtë, i brinjëzuar me seksion të çrregullt disa herë të përdredhur. Lëvorja e lëmuar e bardhërreme, kurora mjaft e dendur. Bisqet të zhvilluar ngjyrë kafe, pushbutë, brrylakë, gjëndorë. Gjethet të thjeshta, distike (të përkundrejta), vezake ose vezake eliptike, të gjata 5-10 cm me majë të theptë, me bazë si zemër ose të rrumbullakosura, buzët dyfish të dhëmbëzuara, njyrë të gjelbër të errët dhe më të celura poshtë, me 10-15 cifte nervaturash të pushëzuara. Lulet në levare të varur, cilindrikë. Frutat akene të vendosura në bazën e pështjellëses, rruzullore të gjera, anash të shtypura, të gjelbra të errëta. është bimë monoike. Ka rrezistencë ndaj ngricave por nuk duron thatësirën gjatë verës. Preferon toka të thella me lagështi mesatare.**
- **Origjina e saj është nga Evropa deri në Azi Jugperëndimore. Tek ne gjendet kudo deri në lartësinë 1500 m mbi nivelin e detit. Në zona urbane mund të përdoret si pengesë natyrore pasi ajo ruan gjethet e reja në dimër dhe duket sikur është përherë e blertë. Mund të krasitet fuqishëm në verë. Përmirëson tokën me masën gjethore të saj.**

Carpinus orientalis - *Shkoza e zezë*

Familja Betulaceae

- **Ka një lartësi më të vogël se shkoza e bardhë që nuk i kalon 6 m. Bisqet i ka shumë të hollë, me push të imët, sythat më të vegjël me 4 qoshe. Gjethet të gjata 2-5 cm dyfish të sharruara imët, me qerpikë, nga poshtë pushbuta, me bisht të shkurtër, me qime. Lëvaret frutore, frutat janë akenë me brakte vezake të mprehtë, jo simetrike të dhëmbëzuara. Lulëzon në mars – maj.**

- **Kryesisht lloj i Evropës juglindore, Azinë e Vogël, Kaukaz, Ballkan. Gjendet deri në lartësitë 1100 – 1200 m mbi nivelin e detit. Ka rrezistencë ndaj thatësirës, lastarizon shumë prandaj mund të mbillet në terrenet e degraduara, gëlqerore të thatë duke e pasuruar tokën me masën gjethore të saj.**

Ostyrja carpinifolia - *Mëlleza*

Familja Betulaceae

- **Lartësia që arrin është 15-20 m, lëvorja e lëmuar, e kuqërreme, plasaritet në pllaka në moshën e pjekurisë. Gjethet janë të thjeshta, të këmbyera, të rënëshme, vezake të thepëta 5-10 cm, buzët dyfish të sharruara, me bisht të shkurtër, të shndritëshme nga sipër dhe me 11-17 palë nervaturash të dukshme, zverdhen në vjeshtë. Lulet në levare të varura, mashkulloret janë cilindrike në skaje të bisqeve, femëroret janë me të shkurtëra, skajore. Fruti një aken i lëmuar, i mbrojtur nga braktet gjethore, me push, ngjyrë të bardhë të verdhërreme. Lulëzon në pranverë.**

- **Në zona urbane mund të mbillet pasi njihet si pemë e fortë që toleron shumicën e kushteve. Parapëlqen tokat acide. Nuk ka kërkesa të shumta mirëmbajtje. Tek ne takohet deri në lartësinë 12300 m mbi nivelin e detit, është lloj i krahinave malore mesdhetare.**

Corylus avellana - *Lajthia*

Familja Betulaceae (Corylaceae)

- **Lartësia 4-7 m me degëzim që nga baza. Lëvorja e murrme e kuqerrëme, e lëmuar dhe e shndritëshme, e paisur me thjerrëza ku më pas ajo plasaritet në sipërfaqe. Bisqet janë brylakë, në fillim të mbuluar nga një push të kuqërremë gjëndrorë e më pas nga një ritidom që rripet në formë cipe, sythat janë vezakë ose rruzullorë me 8 mëlluga me qime. Gjethet të këmbyera në mënyrë distike , me ndajëgjethëza të rënëshme, me llapë pothuaj të rrumbullakët deri vezake e përmbysur të gjata 7-13 cm pak asimetrike, buzët dyfish të sharruara çrregullt, ngjyrë të gjelbër sipër dhe poshtë më të celët dhe me qime. Gjethet kthehen të verdha përpara se të bien në vjeshtë. Dru monoik, lulet mashkullore janë në levare deri në 12 cm të gjata. Frutat të grupuara në 1-2-4 akene vezakë ose rruzullore, me perikarp të hollë të lëmuar të drunjëzuar, të mbështjella deri në majë me një pështjellëse gjethore në formë këmbane**

- **Dru vendas i Evropës dhe jug pererëndim të Azisë. Përdoren në mbjellje si dru i peizazhit vendas, kopshteve të egra etj. Preferon toka të lagështa. Kërkon pak mirëmbajtje, krasitje bëhet në muajt që bima është në gjumë.**



Corylus colurna - *Lajthia e egër*

Familja Betulaceae (Corylaceae)

- **Arrin deri 20 m lartësi, kërcell shumë të drejtë shpesh me degëzime të shumta. Lëvorja me një ritidom të tapëzuar, e hinjtë-verdhërreme. Bisqet të zhvilluara të shndritshëm, të hinjtë të verdhërreme, gjëndore dhe me push, sythat vezakë konikë, të shkurtër. Gjethet 8-12 cm të gjata, të kapura nga një bisht 4 cm në trajtë zemre, buzët dyfish të sharruara ose me vriguj të vegjël, sipër të shogëta, poshtë me push. Lulet levare , ato mashkullore janë të gjata 10-12 cm me ngjyrë të gështenjtë të zbehtë. Frutat në një pështjellëse më e gjatë se vetë kokrra 1-2 cm.**

- **Dru vendas i Evropës juglindore dhe i Azisë jugperëndimore. Mund të përdoret si dru zbukurues për shkak të formës piramidale të rregullt, gjithashtu është shumë tolerante ndaj ambjenteve urbane, mbijeton thatësirave, tokave të varfra dhe nuk shqetësohet nga sëmundje dhe problem me insektet. Tolerante ndaj shumicës së tokave, preferon tokat me PH alkalin.**

Fagus silvatica - *Ahu*

Familja Fagaceae

- **Lartësia 30-40 m dhe me diametër 1-2 m. Kërcelli i drurit të rritur në masiv pyjor është më i drejtë më cilindik dhe i pastruar nga degët në pjesën më të madhe të trungut. Lëvorja e lëmuar, e hollë, ngjyrë gri dhe shpesh me njolla të mëdha të bardhërreme. Druri ka ngjyrë te bardhë të kuqërreme, me rreze palcore të dallueshme, kurse rrathët vjetorë pak të dallueshëm, është pa myje, i rëndë , i fortë, kalbet lehtë në ajër. Bisqet vjetorë janë brrylakë, të murrmë ose të gjelbërremë-ulliri. Sythat janë karakteristikë boshtakë, me majë me mëlluga të shumëta të murrme deri të kuqërreme. Gjethet të këmbyera të distike, vezake ose eliptike 4-10 cm të gjata, me majë të mprehtë dhe me bazë të ngushtuar ose të rrumbullakët, të plota dhe pak të valëzuara, ngjyrë të gjelbër të errët nga sipër dhe më të çelëta nga poshtë, të qerpikta, të verdha në vjeshtë. Lulet në levare të shkurtër-rruzullorë, të varur. Fruti aken me tre qoshe, të murrmë të kuqërreme 1-1,5 cm të gjata, kanë një zhguall ngjyrë ndryshku, të paisur më zgjatime.**
- **Origjinën e ka nga Evropa qëndrore & jugore. Preferon toka neutrale. Nuk duron thatësirat dhe përmbytjet e shpeshta. Kërkon pak mirëmbajtje, krasitja duhet bërë në fund të korrikut, nqs përdoret si specie dekorative duhet krasitur 2 herë në vit që të sigurohemi që të mbajë gjethëzimin gjatë periudhës së dimrit.**



Castanea sativa - *Gështenja*

Familja Fagaceae

- **Arrin 10-20 m lartësi dhe rrallë deri 35 m, ka system rrënjor të fuqishëm, kërcelli i derjtë dhe i trashë. Lëvorja e lëmuar e shndritëshme, e murrme e kuqërreme, ajo plasaritet pas 20-30 vitesh në shirita të gjatë. Bisqet vjetorë janë me qoshe, të murrmë të kuqërremë, të shogët. Gjethet të thjeshta të këmbyera të rënëshmë, me bishtë të shkurtër, me ndajgjethëza vezake, me llapën eliptike-heshtake 12-20 cm, fundi pykor i rrumbullakosur, anët me dhëmbë si të sharrës. Dru monoik, lulet mashkullore të përbëra nga një kupë me 6 vriguj dhe 10-20 thekë, në lëvare cilindrike 10-13 cm të verdha. Lulet femërore të gjelbra dhe ndodhen në fund të lëvareve mashkullore. Fruti aken 2-3 cm i madh dhe me 2-3 kokrra brenda një kupe sferike, e mbuluar me gjemba të gjatë shpues.**
- **Vendi i origjinës është Evropa jugore, Afrika veriore, Azia e vogël dhe zonat e ulta të Himalajeve. Sativa dmth e kultivuar nga latinishtja. Shërben si pemë parqesh, bulevardesh. është gjithashtu e përshtatshme për mjedise nën stress siç janë rrugët urbane. Tek ne gjendet ngë lartësitë 600 – 1200 m mbi nivelin e detit. Tolerante ndaj tokave teksturave të ndryshme të tokës.**



Querqus robur - *Rrënja*

Familja Fagaceae

- Lartësia që arrin është 30-35 m, ka sistem rrënjor boshtor e rrënjë të shumta sipërfaqësore, kërcell të drejtë, vetë krasitet mirë. Shtrihet gati ne gjithë Evropën. Lëvorja ngjyrë të murrme të hinjtë, e fortë dhe me të çara të thella gjatësore. Bisqet janë me lëvore në ngjyrë ulliri në të murrme. Gjethet të këmbyera, të thjeshta të rënëshme, vezake të ngushta në bazë dhe më të gjera në pjesën e sipërme me 5-7 vriguj të rrumbullakosur, asimetrikë, ngjyra e tyre është e gjelbër dhe të mëdha 10-12 cm. është bimë monoike, lulet mashkullore janë në levare të varur, lulet femërore janë në kallinjë që dalin në sqetullën e gjetheve. Frutat janë lende vezake-elptike me ngjyrë të murrme ulliri, të grupuara 2-5 dhe mbahen nga një bisht i gjatë, të mbështjella nga një kupë me mëlluga tjegullore trekëndore, të ngjitura fort.
- Dru vendas i Evropës, veriu Afrikës, Turqia. Preferon toka me lagështi, pjellore. është tolerant ndaj tokave gëlqerore. Rritet në klimë të ndryshme, rrezistent ndaj të ftohtit. Tek ne takohet rrallë në disa zona si Velipojë, Divjakë etj.



Quercus frainetto - *Shparthi*

Familja Fagaceae

- Ka një lartësi 30-40 m dhe diametër deri 1m. Sistem rrënjor të fuqishëm dhe i thellë. Kërcell të drejtë, me lëvore të murrme në të zezërreme, të lëmuar dhe pa plasaritje deri në moshën 10 vjecare më pas shkëputet në luspa të vogla me ngjyrë të hinjtë të errët. Kurora e gjerë e dendur. Bisqet e zhvilluar në ngjyrë ulliri, të pushëzuar në nrini më pas të shogët. Gjethet 10-20 cm të këmbyera, të thjeshta, të përqëndruara në majë të biskut, të gjëra deri vezake të përmbysura-eliptike dhe me veshëza në bazë, shyte në majë, pabisht dhe me 7-9 vriguj të thellë, simetrikë afërsisht horizontal, faqja e poshtme në fillim me push të butë, e hinjtë, e murrme, me 7-9 palë nervatura të dyta. Fruti lende vezake-gjatësore me bisht të shkurtër ose pa, e mbrojtur me një zhguall gjysmë sferik, me mëlluga karakteristike vizake-heshtake me qime të dendura.
- Është lloj i krahinave jugore me verë të gjatë e dimër të butë. Ka kërkesa të pakta ndaj tokës. Preferon toka të shkrifta, acide. Tek ne takohet deri në lartësinë 900 m mbi nivelin e detit. Areali i tij është në Ballkan dhe Itali.



Quercus ilex - *Ilqja*

Familja Fagaceae

- Lartësia arrin 25m, diametri deri 1 m dhe ka sistem rrënjor boshtor. Lëvorja është shumë e lëmuar, e shndritëshme ngjyrë të hinjtë të murrme. Kërcelli jo shumë i gjatë dhe i trashë në bazë. Bisqet ngjyrë hiri me push, sythat të vegjël, të rrumbullakosur, me mëlluga të pakëta me push. Gjethet të qëndrueshme 2-3 vjet të thjeshta të këmbyera, të lëkurta me bisht të shkurtër me qime, të paisur me dy ndajgjethe të murrme, vezake të rënëshme. Llapat janë të gjelbra të shndritëshme sipër dhe të bardha me push poshtë me nervaturën e mesit të drejtë, shpesh me buzë të dhëmbëzuara. është bimë monoike, lulet mashkullore në levare, me push, me pjalmore të verdha, femëroret në kallinj. Frutat janë lende deri 4 cm ngjyrë të murrme, të mbuluara me një pluhurizë të lehtë sipër me shije të hidhur dhe të vetmuara ose nga dy sëbashku me një bisht.
- Rritet në zonën e Lauretum, sidomos në nënzonën e ftohtë. Përshtatet me larmishmëri të madhe tokash, tolerues ndaj thatësirës. Ilqja është lloj gjithmonë i gjelbër me areal në brigjet e Evropës jugore, Afrikë veriore. Tek ne takohet deri në 1000 m. Tolerant ndaj ndotjes urbane, përdoret si rrethues i gjelbër.

Quercus trojana Webb - *Bulgëri*

Familja Fagaceae

- **Lartësia që arrin është 15 m, sistem rrënjor boshtor, ka kurorë të rrumbullakosur e të hapur. Bisqet ngjyrë gri të mbuluar me një push të imët pastaj të shogët. Lëvorja e lëmuar ngjyrë gri të hinjtë në rini pastaj e errët më e ashpër. Sythat vezakë shumë të vegjël. Gjethet të thjeshta të këmbyera, të lëkurta, të pushëzuara me qime yllore në fillim pastaj të shogëta në të dy faqet, ngjyrë të gjelbër të errët e të shndritshme, me bisht të shkurtër. Llapa ka formë vezake të zgjatur, pykore ose si zemër në bazë dhe e thepët në majë, buzët të sharruara çrregullt me 7-14 çifte dhëmbësh majëgjembëzuara ose gati të halëzuara. Bimë monoike. Fruti lende vezake 2-5 cm, e shogët me bazë të rrumbullakosur dhe me majë të mëndafshtë dhe me një thumb. Mbi gjysma e lendes mbulohet nga një kupë. Lulëzon në prill. është lloj mesdhetar submalor.**
- **Është i përhapur në pellgun lindor të Mesdheut. Tek ne gjendet në zonën e dafinës dhe pak atë të gështenjës deri 800 m mbi nivelin e detit.**



Quercus coccifera - *Prralli*

Familja Fagaceae

- **Arrin deri 2 m lartësi dhe rrallë 4-5 m. Sistem rrënjor mesatarisht të thellë, mjaft të zhvilluar. Lëvorja është gri e lëmuar me plasaritje të holla mëllugore në pjesën e poshtme. Bisqet e rinj me push të hollë e më pas komplet të shogët, gri të hinjtë ose gri të murrmë. Gjethet të qëndrueshme të thjeshta, të këmbyera, me bisht të shkurtër, me llapën vezake gjatore, të rrumbullakosura ose si zemër në bazë, me buzë të dhëmbëzuara, gjembore dhe pak gjirake, me majë të mprehtë, më nervatura të dukshme nga sipër. Lloj monoik, lulet mashkullore në levarë të vegjël, me pjalmore të verdha, femëroret po në levare, nga dy ose të vetmuara. Fruti lende vezake ngjyrë të murrme të çelët, mbështjellë nga një kupë me bisht në 2-3 e saj. Lulëzon prill – maj dhe frutat piqen në vjeshtë.**
- **Shtrihet gati në të gjithë Mesdheun. Rrëzistent ndaj të ftohtit, lloji me periudhën e më të gjatë të pushimit vegjetativ, që e bën atë të përshtatshëm të shtrihet në zona dhe më të ftohta. Tek ne deri në lartësinë 900 \ 1000 m mbi nivelin e detit. Përdoret dhe si bimë dekorative. Rritet gati në çdo lloj toke.**

Quercus cerris - *Qarri*

Familja Fagaceae

- **Lartësia deri 35 m, rritet shpejt, ka sistem rrënjor shumë të zhvilluar. Lëvore e lëmuar e fortë e rrudhosur. Bisqet janë me qoshe pak a shumë me qime, me thjerrëza të bardhërreme. Sythat janë të vegjël, vezakë, me push. Gjethet të thjeshta, në formë të ndryshme, kryesisht vezake të përmbysura të zgjatura 5x15 cm, disa herë në formë zemre në bazë, me 4-7 palë vriguj trekëndorë, të plotë ose të dhëmbëzuar që përfundojnë me një thumb të shkurtër, me majë të mprehtë, kanë bisht të gjatë deri 2,5 cm, të shogëta, të errëta. Bimë monoike, lulet mashkullore në levare, cilindrike, të varur, femëroret të vetmuara ose në grupe. Fruti lende pa majë 3x1,2 cm, e murrme, e kuqërreme, me vija të holla gjatësore, e pushëzuar në majë dhe e shogët në pjesën tjeter, me njolla të mëdha, e mbrojtur më tepër se gjysma nga një zhguall me mëlluga vizake. Lulëzon në verë, bimë dritëdashëse.**
- **Vendase e juglindjes së Evropës dhe jugperëndim të Azisë, natyralizuar gati në gjithë Evropën. Mund të mbillet në zona urbane si specie me zhvillim të madh. Qarri preferon toka me lagështi, pjellore, tolerant ndaj tokave gëlqerore. Kërkon pak mirëmbajtje. Tek ne takohet deri 1200 m mbi nivelin e detit.**

Quercus macrolepis - *Valanidhi*

Familja Fagaceae

- **Arrin lartësi 15-20 m, kërcellin e ka të shkurtër e të trashë, i drejtë. Lëvorja e murrme e errët pastaj bëhet e ngjeshur dhe plasaritet. Bisqet të verdhërremë ose të bardhërremë me push të hollë kafe. Gjethet të këmbyera të thjeshta, të lëkurta vezake-heshtake 6-10x3-7 cm, të vrigulluara ose të dhëmbëzuara shumë, e bazë në formë zemre, me qime të dendura në të dy faqet në fillim pastaj vetëm poshtë. është bimë monoike, lulet mashkullore në levare, femëroret me bisht të shkurtër. Frutat lende të vetmuara ose të grupuara, shumë të mëdha, me thumb, mbrohet nga një kupë,gati pa bisht, me mëlluga të gjera. është lloj heliofil dhe kserofil.**

- **I përhapur vetëm në Mesdheun lindor, Ballkan, Azinë e vogël, Itali. Rritet tek ne deri në lartësinë 900 m mbi nivelin e detit.**



Quercus pubescens - *Bungëbuta*

Familja Fagaceae

- **Arrin lartësi 15-20 m, ka sistem rrënjor të fuqishëm, me zhvillim të qartë të boshtit kryesor. Lëvorja gri e murrme e ngjeshur. Bisqet me push të butë si kadife, ngjyrë të hinjtë. Gjethet të këmbyera të thjeshta, vezake të zgjatura 5-8 cm, me bisht të gjatë, e buzë të vrigulluara, me 4-7 palë vriguj të plotë ose me dhëmbëzim të mprehtë, shyte ne majë, pykore ose si zemrër në bazë. Gjethet bien vonë në dimër. është bimë monoike, me lule mashkullore në levare cilindrike 5 – 10 cm, me thekë pjalmore të verdha. Fruti lende vezake e zgjatur, me vija të errëta, mbrohet nga një kupë me mëlluga të ngjeshura. Qëndrojnë nga 3-4 sëbashku me një bisht të shkurtër. Ka rritjen më të ngaldaltë se gjithë dushqet e tjerë. është lloj termofil, kserofil dhe preferon tokat gëlqerore, shpatet me diell.**

- **Shtrihet gati në gjithë Evropën jugore dhe shkon deri në Kaukaz. Tek ne takohet deri në lartësinë 1100 m mbi nivelin e detit.**



Ulmus campestris (Minor) - *Vidhi i fushës*

Familja Ulmaceae

- **Lartësia deri 30-40 m dhe me diametër 2-3 m, me sistem rrënjor boshtor sipërfaqësor. Kërcelli i drejtë, i vetëkrasitur dhe i trashë në bazë. Lëvorja e lëmuar, gri e zezërreme, më vonë me të çara të thella gjatësore. Bisqet njëvjeçarë të hollë. Të shogët ose lehtësisht me push, të murrme në të kuqërreme. Gjethet të thjeshta, të këmbyera, të rënëshme, vezake 5-9 cm me buzë dyfish të dhëmbëzuara, me majë të mprehtë ose të thepët dhe me bazë asimetrike, me 7-15 cifte nervaturash të dyta. Lulet të vendosura në tufa sqetullore, të kuqe të purpurta, hermafrodite. Fruti shojzë me flatër afërsisht të rrumbullakët, fara e vendosur në mesin e flatrës.**

- **Kërkon kushte të mira të tokës, të freskta, të thella dhe shumë pjellore. Ka kërkesa ndaj dritës, nxehtësisë. Tek ne takohet në zona fushore , buzë ujrave, deri në lartësinë 1500 m mbi nivelin e detit.**



Ulmus glabra Hudson - *Vidhi i malit*

Familja Ulmaceae

- **Lartësia që arrin është 25-30 m, lëvorja e lëmuar deri në moshë mesatare pastaj plasaritet në formë luspash të tapëzuara hollë. Bisqet të zhvilluara ngjyrë të murrme- të gjelbërreme ose të kuqërreme, me push të hollë. Gjethet të rënshme, të thjeshta të këmbyera, vezake ose eliptike, të gjera 9-15 cm, asimetrike me bazë, buzë dyfish të dhëmbëzuara, me bisht të shkurtër, me 12-18 cifte nervaturash anësore, shumë të ashpra. Lulet hermafrodite në lëmshe me ngjyrë të kuqe të purpurt, të ngritura përpjetë. Fruti shojzë vezake dei rruzullore, me flatër majëngrënë dhe me farën e vendosur në mesin e saj.**
- **Më pak kërkues ndaj nxehtësisë dhe tokës se vidhi i fushës. Ka kërkesa të tokës për lëndë ushqyese, preferon tokat e shkrifta. Shtrihet gati në të gjithë Evropën duke u ngjitur më tepër në veri dhe veriperëndim.**



Celtis australis L - *Caraci*

Familja Ulmaceae

- **Arrin 18-25m, kërcell të drejtë, shumë i degëzuar. Lëvorja e lëmuar ngjyrë hiri e mbyllur. Bisqet të murrme të gjelbër, të hollë të epsheëm, me push, shpesh të varura. Gjethet të thjeshta, të këmbyera, vezake heshtake, pothuaj distike 4-15 cm, buzë të sharruara me dhëmbë të imët e të mprehtë, të gjelbra të errëta sipër dhe poshtë me push të butë, me tre nervatura kryesore, me bisht të shkurtër, asmietrike. Lulet të vogla të gjelbra, sqetullore të vetmuara, me pjalmore të verdha, hermafrodite ose poligame. Fruti bërthokël vezake ose rruzullore, me bisht më të gjatë se ai i gjethes, i shogët, i ëmbël, i ngrënshëm, kur piqet merr ngjyrë të murrme të zezë, në fillim i gjelbër.**
- **Është lloj termofil, , preferon toka pjellore por dhe tokat ranore. Është lloj mesdhetar me areal Evropën Jugore, Azinë Perëndimore dhe i kultivuar në Evropën Qëndrore. Tek ne gjendet deri në lartësinë 1000 m mbi nivelin e detit.**

Morus alba - *Mani i bardhë*

Familja Moraceae

- **Lartësia që arrin është 15-20 m. Ka kërcell të drejtë, është i degëzuar dhe i çrregullt. Lëvorja është e murrme në të hinjtë me plasaritjë gjatësore. Bisqet të zhvilluara, të murrmë në të hinjtë, të shogët dhe me pak push. Gjethet të këmbyera, vezake ose elipltike, të plota ose me 3 – 5 vriguj, asimetrike, buzë të dhëmbëzuara çrregullt. është bimë monoike ose dioike me lule mashkullore në levare cilindrike, femëroret afërsisht të rrumbullakta. Frutat janë vezake të rrumbullakosur, të gjatë, mishtakë, të bardhë dhe kur piqen bëhen të kuqërremtë, me bisht të gjatë sa fruti, të ngrënshëm.**
- **Preferon terrene të freskëta, eviton tokat argjilore dhe ato me lagështi të qëndrueshme. Me origjinë është nga Kina dhe Japonia, në Evropë është futur rreth shek. VI. Në vendit tonë gjendet gati kudo. Druri i tij mund të përdoret në zdrukthari. Druri manit të bardhë parqet rëndësi dhe për kultivimin e krimbit të mëndafshit.**



Morus nigra - *Mani i zi*

Familja Moraceae

- **Lartësia që arrin është 15(25) m, me i fortë dhe me kurorë më të dendur se mani i bardhë, dru gjethe rënës. Ka kurorë të gjelbër, bisqet i ka me push. Gjethet zakonisht të pavrigulluara, me buzë të ndara thellë në mënyrë të çrregullt, llapa e gjethes është më e madhe, në bazë është si zemër dhe me majë të mprehtë ose të thepët, me push ose e shogët sipër, me qime pushbutë poshtë. Zakonisht është bimë dioike, frutat më të mëdhenj dhe kanë ngjyrë të kuqe të errët deri në të zezë, të athët.**

- **Origjina është nga Azia e Vogël por i përhapur shumë në Evropë. Tek ne takohet gati kudo. Fruti i tij mund të përdoret dhe për prodhim rakie. Kërkon pak mirëmbajtje, rritet shpejt, duron thatësirën por kujdes duhet sepse frutat që bien bëjnë shumë pis. Duron gati çdo lloj kushti toke**



Viscum album L - *Vjezhdulla e bardhë*

Familja - Santalaceae (Viscaceae)

- **Shkurre që paraziton mbi drurët pyjorë, përherë i gjelbër. Kërcell me degëzim dikotomik, bisqet i ka të gjelbërreme që shkeputen kollaj. Gjethet i ka të qëndrueshme, të përkundrejta, vezake të përmbysura 2-4 cm, të plota, të shogeta, pa bisht, të gjelbërreme të murrme. Lulet i ka të grupuara me nga tre në majë të degëve, të verdh/jeshile. është bimë dioike, futat janë rrushqe të rremë të bardhë dhe rruzullorë që piqen në dhjetor dhe mbeten në bisk deri në pranverë, frutat përmbajnë një lëndë ngjitëse. Gjithë pjesët e bimës janë helmuese nëse gëlltiten.**

- **Bima fiksohet mbas trungut të bimës strehuese dhe thith lëndën ushqyese minerale. Është lloj i përhapur në Evropë Qëndrore, Jugore dhe Azi. Ajo paraqet interes dhe në mjeksi, ku kuron hipertensionin.**



Loranthus europaeus - *Evulla*

Familja - Santalaceae (Viscaceae)

- **Evulla është një gjini e një bime parazitare që rritet në degët e pemëve. Degët e reja i ka me ngjyrë të murrme dhe me vendosje dikotomike. Gjethet i ka të rënëshme, vezake të përmbysura 2-4 cm me buzë të plota ose lehtësisht gjirake, të gjelbra të errëta me bisht të shkurtër. është bimë dioike me lule të vendosura në lulesa në formë kalliri. Frutat i ka rrushqe që janë rruzullore të rreme dhe me ngjyrë të verdhë, piqen në tetor.**

- **Farat shpërndahen me anë të shpendëve. është e përhapur në Evropën Jugore kryesisht në pyjet e dushqeve. Tek ne paraziton por aq shpesh sa vjezhdulla.**



Berberis vulgaris L - *Mëlqinja e rëndomtë*

Familja - Berberidaceae

- **Është një shkurre që arrin lartësi 2-3 m. Degët i ka me kanale dhe me gjemba të trefishtë të gjatë 1-2 cm. Gjethet i ka të rënëshme, eliptike deri vezake të përmbysura, të gjata 2-4 cm, të dhëmbëzuara, sipër me ngjyrë të gjelbër të errët, poshtë të zbehta ose ngjyrë të hinjta. Lulet të verdha të shkëlqyeshme, në vile të varura, me aromë mjalti. Lulëzon në maj-qershor. Frutat janë rrushqe elipsoidale me ngjyrë të kuqe të shkëlqyeshme ose të purpurt, me dy bërthama.**

- **Është lloj i klimës malore, mjaft rrezistent ndaj ngricave, dritëdashës, preferon tokat gëlqerore. Tek ne takohet në malet e Shqipërisë së Veriut e të Mesme. Lëvorja, frutat dhe gjethet përdoren në mjekësi për kurim të sëmundjeve të ndryshme. Mund të përdoret si lloj dekorativ në parqe e lulishte për shkak të ngjyrës së bukur të gjetheve në vjeshtë dhe frutave.**



Magnolia grandiflora L - *Manjola*

Familja - Magnoliaceae

- **Dru përherë i gjelbër me kurorë gati konike dhe që hapet pas rritjes. Arrin lartësi deri 30 m dhe ka kërcell të drejtë me kurorë të gjerë piramidale, me lëvore të lëmuar. Bisqet i ka të trashë e me ngjyrë ndryshku. Gjethet 12-25 cm të trasha të lëkurta me ngjyrë të gjelbër të errët dhe pa push. Nga poshtë gjethet janë me push e me ngjyrë ndryshku e në disa raste nuk ka. Lulet i ka të mëdha dhe me kurorë të gjerë, të gjata deri në 25 cm, me petale të trasha e ngjyrë të bardha e me erë të këndëshme. Fruti është boçe që arrin 12x16 cm.**

- **Origjina e saj është nga pjesa jugore e Amerikës së Veriut. Si dru dekorues mund të përdoret në zona urbane për bukurinë që ka dhe për nevojnë për përkujdesje të pakët. Mund të përdoret dhe si zbukurues muresh pasi ngjitet por ka nevojë për litarë dhë mbështetës të tjerë.**



Magnolia denudate Desr- Manjola kineze

Familja - Magnoliaceae

- **Arrin lartësi deri 10 m. Preferon vende në diell dhe lulëzon në mes të pranverës. Dru gjetherënës ose si shkurre në përgjithësi. Gjethet e pjekura janë të lëmuara nga sipër dhe me qime nga poshtë, të gjata deri në 15 cm dhe bisht deri në 3 cm. Lulet të gjata deri 15 cm, me 9 petla të bardha, çelin para gjethëzimit, shumë aromatike. Lëvorja është gjithashtu e lëmuar. Fruti është një "boçe" kafe deri në 12 cm.**

- **Prejardhjen e ka nga Kina Qëndrore dhe Lindore. Mbillej në kopshtet budiste që në vitin 600 para Krishit dhe në Evropë ka ardhur rreth viteve 1745 – 1820. Emrin manjola e ka marrë për nder të botanistit francez Pierre Magnol dhe denudata dmth zhvesh prej luleve që dalin nga sythat lulorë. Nga ana dekorative ka shumë vlera si shkurre ose dru i vogël që lulëzon në pranverë. Duhet pak kujdes ndaj erërave të forta dhe ngricave. Preferon toka të pasura me humus dhe nuk duron kushtet e thatësirës.**



Liriodendron tulipifera L – Liriodendri (Tulipan)

Familja Magnoliace

- **Në vendin e origjinës arrin deri 50 m lartësi. Lëvorja me ngjyrë të hinjtë. Gjethet janë të rënëshme, me 2-4 vriguj, 7-15 cm të gjata, nga sipër të lëmuara, në vjeshtë marrin ngjyrë të verdhë ari të ndezur. Lulet janë dyseksore, 5 cm të gjata, shumë të bukura por jo aromatike. Fruti është aken të grumbulluara në frytesa, qëndrojnë në dru gjatë dimrit.**

- **Është lloj me rritje të shpejtë. E gjejmë në zonën e Gështenjës. Prejardhjen e ka nga Amerika e Veriut, tek ne gjendet për arsye dekorative. Toleron mjaft mirë ndotjen urbane.**



Laurus nobilis L - *Dafina*

Familja - Lauraceae

- **Arrin lartësi deri 18 m dhe trashësi të trungut deri 50 cm, normalisht rritet në trajtë shkurreje. Degët i ka të holla të shogëta që formojnë një kurorë piramidale. Lëvorja në fillim është e gjelbër pastaj me ngjyrë gri. Gjethet janë të qëndrueshme të thjeshta heshtake të zgjatura, të mprehta ose të thepëta në majë dhe pykore në bazë, me ngjyrë të gjelbër të errët, të shkëlqyeshme sipër dhe të çelëta poshtë, të lëkurta, të lëmuara dhe shumë aromatike. është bimë dioike ku lulet janë si lulesa në formë ombrelle sqetullore nga 4-6 sëbashku dhe me ngjyrë të bardhë të në të verdhë. Lulet mashkullore me 8 – 12 thekë në qerthuj dhe femëroret me krekëza. Fruti bërthokël vezake i gjelbër dhe kur piqet bëhet i zi, piqet në tetor – nëntor. Dafina është lloji tipik i klimës mesdhetare.**
- **Është shumë e qëndrueshme ndaj thatësirës. Është lloj dritëdashës por rritet dhe në hije, ka jetëgjatësi të shkurtër. Ka përdorim të gjërë në farmaceutikë, parfumeri, gastronomi. Çmohet shumë dhe si lloj dekorativ për vlerat që ka dhe format që merr me anë të qethjes.**



Platanus orientalis L - *Rrapi*

Familja - Platanaceae

- **Lartësia që arrin është 40-50 m i lartë dhe 3-4 m i gjërë, jeton shumë, gjethe rënëse, rrënjëzim të fuqishëm. Lëvorja në rini është e lëmuar e hinjtë, te drurët e rritur lëvorja është ngjyrë e hinjtë e bardhërreme lara lara dhe shkëputet si pllaka në degët e kurorës. Bisqet me qime të shumta. Gjethet janë të vrigulluara, të gjata 12-20 cm të gjata. është lloj monoik, lulesat janë si kaptinëza rruzullore me bisht të gjatë. Frutat janë akene të bashkuara në formës e një kokrre të rrumbullakët me bisht të gjatë.**

- **Është me origjinë nga Evropa Jugore, dhe Jug - perëndimi i Azisë. Si dru i ambjenteve urbane përdoret shumë prej përmasave të mëdha që arrin. Njëherë që instalohet duron mjaft mirë thatësirën apo dhe ndotjen urbane, gazrat. Një problem është kur gjethet lëshojnë pushin e tyre, krijojnë alergji apo dhe rrënjët anësore që lëshon. Rrapi është pak kërkues ndaj tokave por preferon toka me lagështi.**

Platanus occidentalis L - *Rrapi*

Familja - Platanaceae

- **Është dru i përmasave të mëdha, gjethe rënës. Gjethet i ka të alternuara, të thjeshta, me 3- 5 lobe, bisqe të shogët, të kuqërremtë. është dru monoik, si lulet femërore dhe maskullore janë të vogla në tufëza. Fruti është aken sferik që piqet në nëntor, me një bisht të gjatë. Lëvorja është e hollë, kafe në jeshile që rripet në copa.**
- **Është dru masiv me përmasa të mëdha, duron thatësirën. Rrapi i perëndimit është mjaft i përshtatshëm për zonat urbane, rrugë, parqe etj pasi duron mjaft mirë ndotjen urbane, krijon hijëzim të dendur. Kujdes duhet treguar në distancat e mbjelljes pasi rrënjët e tij janë të fuqishme sidomos ato anësore. Krahasuar me rrapin e lindjes ka të mirë se gjethet nuk kanë push. Vendi i origjinës është Amerika e Veriut, është sjellë në Evropë rreth shek. XVII.**



Pittosporum tobira - *Pitospora*

Familja - Pittosporaceae

- **Shkurre ose dru me lartësi 6-8 m, lulëzon herët në pranverë. Gjethet të qëndrueshme, të lëkurta, vezake të përmbysura me gjatësi 5-9 cm, me majë të cungët, përfundojnë me një bisht të shkurtër dhe kanë ngjyrë të gjelbër të errët, të shkëlqyeshme. Lulet janë dyseksore, të bardha-të verdha, me vastakë të dendur, me erë si të portokallit. Frutat janë kapsula, të brinjëzuara me qime të dendura, farat i ka me shumë rrëshirë.**
- **Shkurre vendase e Japonisë, përdoret shumë si shkurre dekorative nga bukuria dhe aroma e këndëshme që lëshon, pranon mjaft mirë krasitjen. Shërben shumë mirë si bimë dekoruese e kopshteve, shtëpive etj. është mjaft tolerante ndaj thatësirës, kushteve të tokës por jo ndaj të ftohtit të madh. Nuk kërkon shumë vëmëndje, nqs do ndërhyjmë me krasitje, bëhet në mes të pranverës.**

Rubus idaeus L- *Miedra*

Familja - Rosaceae

- **Shkurre në formë tufe, me kërcej të shumtë të ngritur përpjetë. Bisqet janë brrylakë me vija të gjelbra të hinjta, me gjemba të dendur, të vendosur shpesh vetëm në bazë. Gjethet të këmbyera, të përbëra tekpendore, me 5-7 gjethëza në kërcenjt njëvjeçarë dhe 3 gjethëza në ato dy vjeçarë. Gjethet janë vezake, dyfish të sharruara, të shogëta, të gjelbra nga sipër dhe të bardha me push nga poshtë. Lulet janë të bardha të vogla, me thekë dhe karpela të shumta, në vile. Fruti është bërthokël e shumfishtë, rruzullore, lehtësisht e shkëputshme, në pjekuri merr ngjyrë të kuqe të errët, është i lëngshëm, i ëmbël dhe aromatik.**
- **Miedra është e përhapur në Evropë dhe Azi sidomos në krahinat me klimë të ftohtë zakonisht nën çeltira, është dritë dashës. Fruti përdoret në ëmbëlsira etj.**



Rubus ulmifolius Schott. - *Manaferra*

Familja - Rosaceae

- **Është shkurre 2-3 m lartësi, rrënjët përhapen shpejt. Bisqe me kënde, me gjemba me një shtresë të hollë pluhurizë. Gjethet të përbëra nga 3-5 gjethëza te shogët të gjelbërremë të shndritshme nga sipër, të bardhërreme nga poshtë, buzë të dhëmbëzuara lehtë. Lulet të bardhërreme deri trëndafili, hemafrodite, në melthe dhe me push të imët. Fruti është një bëthokël e shumëfishtë, e ngënëshme, me ngjyrë të zezë. Piqet në gusht – shtator.**

- **Preferon klimë të ngrohtë, nuk ka kërkesa ndaj tokës duke u përhapur gati kudo në të gjithë Evropën. Fruti i tij përdoret për reçelëra, liker, alkol, embëlsira etj. Në zonat urbane mund të mbillet si pjesë e skemave natyrale por që duhet kujdes pasi shtohet shumë shpejt, duke prerë rrënjët që rriten së tepërmi.**



Rosa canina L - *Trëndafili i qenit*

Familja - Rosaceae

- **Shkurre me lartësi 2-3 m me degë me gjemba të fuqishëm, me majë të përkulur, të shtypur anash e me bazë shumë të gjerë. Gjethet të këmbyera, të përbëra tekpendore dhe me ndajgjethëza, ka rreth 7 gjethëza, vezake ose eliptike të gjata 2-4 cm, me buzë njëfish të sharruara disa herë dyfish të sharruara. Lulet janë skajore 1-3 sëbashku, me 5 petal ngjyrë trëndafili ose të bardha. Fruti i shumëfishtë, i formuar nga një pjesë mishtake elipsoidale, e kuqërreme, që ka brenda akene të shumtë me qime. Piqet gusht-shtator**
- **Vendase e Afrikës Veri-Perëndimore, Azisë Perëndimore dhe e Evropës. Përdorej përpara për të kuruar kafshimin e qenit të tërbuar. Përdoet akoma sot në mjeksi për kurim veshkash etj. Fruti i tij është i pasur me shumë vitaminë C,D,P etj. Mund të përdoret dhe si stabilizues toke për përmirësim terrenesh.**



Rosa pendulina L - *Trëndafili i alpeve*

Familja - Rosaceae

- **Shkurre deri 1 m lartësi, me kërcell të hollë të gjatë, zakonisht pa gjemba, gjetherënëse. Gjethet i ka të përbëra, të gjata 2-7 cm, dyfish apo trefish të sharruara, me dhëmbë të mprehtë gjëndorë. Po kështu bishti dhe nervatura kryesore janë me gjendra. Lulet janë të veçuara të mëdha deri në 5 cm, ngjyrë trëndafili të purpurt ose vjollcë, me nënpetla të pandara, të qëndrueshme. Fruti ellipsoidal 2 cm me ngjyrë të kuqe të shkëlqyer dhe zakonisht i varur.**

- **Takohet në Evropën Jugore, Qëndrore dhe Ballkan. Preferon toka lehtësisht acide dhe të pasura me azot. Kultivohet në grupe të vegjël përshkak të luleve të bukura që bën, duron hijëzimin. Vlerë të madhe ka fruti që përmban 9 % vitamin C në vend të 1 % që përmban Rosa canina.**



Pyrus pyraster L. Burgsd. – Dardha e egër
Familja Rosaceae

- Dru mesatar, deri 15 m lartësi, disa herë si shkurre. Lëvorja me ngjyrë të mbyllur, me të çara jo të thella. Gjethet të këmbyera, të thjeshta, me bisht gati sa gjethja, me buzë të dhëmbëzuara imët, me majë të mprehtë, në fillim me push pastaj të shogët. Lulet janë hermafrodite, në vastakë, të ngritur përpjetë. Lulëzon prill-maj. Fruti është kokërr me tul, të ngënshëm që piqet tetor – nëntor.
- Ka pak kërkesa ndaj tokës, i rreziston thatësirës. Origjinën e ka nga Evropa dhe Azia. Tek ne takohet deri në lartësitë 1500 m mbi nivelin e detit. Ky dru mund të përdoret dhe për stabilizimin e terreneve të eroduara.



Pyrus amygdaliformis Vill. - *Gorrica*
Familja Rosaceae

- Dru ose shkurre që arrin deri 8 m ose shkurre. Lëvorja e murrme dhe e çarë. Bisqet të murrmë. Gjethet vezake ose eliptike, me push, ngjyrë të gjelbërreme në të hinjtë, me majë të mprehtë, të gjata 3-7 cm, me bisht. Lulet të bardha, me petla të vogla, me pjalmore të kuqe në manushaqe, çelin fund marsi deri fund maji. Fruti kokërr e rrumbullakët deri 4 cm që quhet gorricë, e gjelbër me bisht të shkurtër, piqet në tetor, e ngënëshme.
- Kërkon klimë të butë,shumë rrezistent, rritet ngadalë.

Malus sylvestris Mill - *Molla e egër*
Familja Rosaceae

- Lartësia 6-10 m, herë si shkurre, ka kërcell të shkurtër dhe degëzim jo të rregullt, lëvorja e murrme e zezërreme, në pllaka. Bisqet i ka të murrmë të kuqërremë, shpesh gjëmborë, me majë, me qime në fillim, pastaj të shogët. Gjethet të këmbyera eliptike ose gati të rrumbullakta, të gjata 3,5 x 2,5 cm, me bisht 1-2 cm, me buzë të sharruara imët ose të sharruara ura ura, me nervatura shumë të dukshme. Lulet hermafrodite, të bardha ose trendafili, në vastakë ombrellorë, të ngritura përpjetë. Fruti mishtak, rruzullor i vogël, me shije të athët, piqet shtator - nëntor.
- Me origjinë Evropiane dhe takohet deri afër rrethit polar. Takohet deri në lartësitë 1600 m mbi nivelin e detit. Fruti përdoret për të nxjerrë raki ose uthull.



Sorbus aucuparia L - *Vadhja e egër*

Familja Rosaceae

- **Lartësia që arrin është 15- 20 m por gjendet dhe si shkurre, lëvorja e lëmuar, e shndritshme. Bisqet i ka ngjyrë hiri, me push pastaj të murrmë, të kuqërremtë, të shogët. Sythi skajor është karakteristik, 1-2 cm i gjatë, me majë të përkulur e mëlluga të zezërreme, me qime. Gjethet të përbëra, tekpendore, të gjata 10 (16) cm, me 9-17 gjethëza 4-5 cm, gjatore- heshtake, me buzë të sharruara mprehtë, pa bisht dhe në vjeshtë marrin ngjyrë të kuqe të errët me efekt dekorativ. Lulet janë hemafrodite, të bardha, në vastakë skajorë, të ngritur përpjetë. Frutat janë mishtake vezake ose rruzullore, me ngjyrë të kuqe dhe rrallë të verdhë, piqen në gusht – shtator, qëndrojnë në pemë deri vonë në dimër, i pangrënshëm.**

- **Ka pak kërkesa ndaj tokës, rritet mirë në klimë malore e kontinentale. është përhapur gjërësisht në Evropë, tek ne takohet deri në 1800 m mbi nivelin e detit. Ka veti dekorative të mira.**

Sorbus torminalis L - *Vadheviçja*

Familja Rosaceae

- **Arrin lartësi 20-25 m por shpesh gjendet si shkurre. Ka lëvore të lëmuar deri në moshën 20 vjeçare pastaj trashet dhe me mëlluga. Kurora është e gjerë dhe hijëzon mirë. Bisqet e zhvilluar pak si me kënde, me ngjyrë të murrme- gri të shndritëshme. Sythat vezake-rruzullore, të shtypura, të gjelbërreme. Gjethet të thjeshta, të këmbyera, me bisht 2-5 cm, me ndajgjethëza vizake, të gjata, me llapë vezake dhe të vrigulluara 7-12 cm të gjata, me 3-4 cifte vrigujsh, marrin ngjyrë të kuqe në vjeshtë. Lulet hemafrodite, në vastakë, të bardha, me pjalmore të verdha. Fruti kokërr, elipsoidale ose vezake, e madhe, e verdhë, e kuqërreme, me pikla të bardhërreme, e fortë, e pangrënshme prej qelizave të drunjëta.**
- **Origjina është nga Evropa, Azia e Vogël, Afrika Veriore. Tek ne takohet dendur. Ka vlera të mëdha dekorative, për masën gjethore dhe frutat.**



Sorbus aria L – Vadheviçja e bardhë

Familja - Rosaceae

- **Shkurre ose dru, kurorë vezake të dendur. Lëvorja gri e zezërreme me njolla të bardha. Gjethet të thjeshta, të këmbyera, me llapë vezake-eliptike, me buzë dyfish të sharruara dhe pak të vrigulluara, të shogëta, nga poshtë me push të bardhë. Lulet janë hermafrodite, në vastakë, të ngritur përpjetë, të bardha, çelin në maj – qershor. Fruti kokërr rrumbullake, ngjyrë trëndafili-portokalli deri të kuqe, me tul të verdhë, i ëmbël, i ngrënshëm, piqet shtator- tetor.**

- **Është lloj Evropian, zakonisht gjendet në shpate gëlqerorë të diellëzuara mirë. Ka rëndësi të madhe si bimë zbukuruese nga më të mirat pasi mund të përhapet dhe në zonat fushore.**



Sorbus domestica (L) – Vadhja e butë
Familja - Rosaceae

- Arrin lartësi deri 13 m, lëvoren e ka me mëlluga të ngjashme me dardhën e egër. Bisqet me ngjyrë ulliri të murrmë, në fillim me push pastaj të shogët. Gethet të këmbyera, të përbëra tek pendore, rreth 20 cm të gjata, me 11 – 21 gjethëza, të rrumbullakosura në bazë, me buzë të plota afër bishtit dhe të dhëmbëzuara pjesa tjetër, me nghyrë të gjelbër. Lulet janë hermaphrodite, të bardha, në vastakë. Lulëzon në maj, fruit kokërr rrumbullakë, 2-4 cm, nghyra e verdhë-kuqërremtë, me pika, i ëmbël, piqet në shtator.

- Rritet në klima të buta, të ngrohta, zhvillohet mirë në toka pjellore, lehtësisht acide. Jeton 400 – 500 vjet. është i përhapur në mënyrë natyrore në Evropë, Azi e Vogël dhe Afrikë e Veriut, gati kudo në zonën e dafinës e të gështenjës. Mund të përdoret i dru frutor dhe zbukurues njëkohësisht.



Pyracantha coccinea (Roem) – Ushinthi
Familja Rosaceae

- Shkurre përherë e gjelbër deri në 2- 3 m. Bisqet i ka me gjemba. Gjethet të qëndrueshme, eliptike deri heshtake, 2-4 cm të gjata, me buzë të dhëmbëzuara imët, ngjyra e gjelbër. Lulet janë të bardha, në vastakë, çelin në qershor. Frutat janë rruzullorë, ngjyrë të kuqe, piqen në tetor.

- Është lloj që kërkon klimë të ngrohtë mesdhetare, toka të thella, të freskëta dhe vende të hijëzuara. Origjinën e ka nga Evropa Jugore, Turqia, Kaukazi etj. Tek ne gjendet gati kudo në zonën e dafinës dhe atë të gështenjës. Për nga bukuria mund të themi se është ndër shkurret më të bukura për shkak të frutave që ka të cilat qëndrojnë deri në dimër. Pranon shumë të krasitet sipas formave që duam.

Crataegus monogyna Jacq. - *Murrizi një bërthamësh*
Familja - Rosaceae

- Është shkurre deri 8 m, ka kërcell të çrregult, lëvore mëllugore, me ngjyrë të hinjtë të murrme. Bisqet i ka të shogët, të murrmë, të kuqërremtë, me gjemba. Sythat janë rruzullorë, të kuqërremtë. Gjethet të këmbyera, rombike-vezake, me buzë të vrigulluara thellë, me 3-7 vriguj të çrregullt, të sharruara në majë dhe me ngjyrë të gjelbër. Lulet të plota, të bardha dhe janë në vastakë. Fruti bërthokël, i kuq, vezak ose sferik, përmban vetëm një farë të fortë.

- Është lloj me amplitudë të gjerë ekologjike, pëlqen vendet e nxehta, rrezistent ndaj thatësirës. është i përhapur kudo në Evropë. Lulet e murrizit përdoren në farmaceutikë. Frutat e tij mund të konsumohen të freskëta ose si çaj. Mund të përdoret mjaft mirë si mur i gjelbër rrethues.



Crataegus orientalis (Pall) - *Murrizi i butë*

Familja - Rosaceae

- **Shkurre që mund të arrijë 6-7 m, bisqet i ka të transformuar në gjemba dhe me push. Gjethet të gjata 5 cm, me vriguj të çarë thellë, poshtë me push me ngjyrë hiri. Lulet 1,5 cm, të dendura shumë, të grupuara në melthe ose vastakë, me push të argjendë. Fruti kokërr e rrumbullakët ngjyrë të kuqërreme, me qimëza, 3-5 bërthamëza, piqet në shtator.**
- **Tek ne takohet gati kudo në zonën e dafinës, zonën e gështenjës dhe rrallë në zonën e ahut. Ka të njëjtat përdorime sikurse dhe murrizat e tjerë. Shkurre e zonës së Mesdheut, Turqisë, Kaukazit.**

Crataegus pentagyna W et K. - *Murrizi pesë bërthamësh*

Familja - Rosaceae

- **Është shkurre që nuk i kalon 5 m, me bisqe të hinjtë ose të gjelbër-të murrmë, me push, jo të shndritshëm. Gjethet me 3-7 vriguj të thellë deri 2/3 e gjysmës së llapës. Lulet kanë 5 shtyllëza dhe thekë të kuq, çelin në prill ose maj. Frutat janë elipsoidalë, të zinjë, të purport, me pesë fara, piqen në gusht-shtator.**
- **Tek ne takohet rrallë në skaj të pyjeve fletorë në zonën e Veriut. Për shkak të gjetheve që marrin ngjyrë ari në vjeshtë dhe të kokrrave të purpurta vlen të përdoret dhe si dhkurre decorative nëpër parqe. Bimë vendase e Evropës Jug-Lindore.**

Prunus sipnosa L – Kulumbria

Familja - Rosaceae

- **Shkurre gjembore, shumë e dendur, zakonisht nga 3-5 m lartësi. Lëvorja në fillim e lëmuar dhe dhe me plasaritje horizontale. Bisqet janë të rrumbullakët dhe me push, bisqet anësorë përfundojnë me nje gjemb. Gjethet janë të këmbyera, eliptike ose vezake, 2-4 cm të gjata, me buzë të sharruara imët. Lulet janë të vetmuara, me bisht, të bardha, çelin në prill-maj, para gjethëzimit. Frutat janë bërthokla të ngritura përpjetë, të zeza, të kaltërreme, me shije të athët, piqen në shtator dhe mbeten në degë deri në pranverë.**
- **Është shkurre kserofite, pak kërkuese ndaj tokës, mund të luajë rolin e species pioniere. është lloj dritëdashës por duron dhe hijëzimin. është i përhapur në të gjithë Evropën dhe Afrikën Veriore. Tek ne gjendet deri në lartësin 1500 m mbi nivelin e detit. Si shkurre mund të përdoret për veshjen e terreneve të degraduara, gjithashtu dhe për krijimin e gardheve të gjallë.**

Prunus avium L – Qershia e egër
Familja - Rosaceae

- Arrin lartësinë 20-25 m, ka kërcell të drejtë dhe cilindrik. Lëvorja e lëmuar, me ngjyrë të murrme-viole deri në të kuqe të murrme e cila ripet në rripa rrethorë, në pleqëri ka lëvore më të ashpër. Ka kurorë të gjërë, piramidale me degë të ngritura përpjetë. Gjethet janë të këmbyera, vezake të zgjatura, me bisht, buzë dyfish të sharruara. Lulet janë hermafrodite, të bardha, në vastakë, të shtrira ose të varura, dëmtohen nga ngricat e vonëshme. Fruti është bërthokël rruzullore, me ngjyrë të kuqe-të errët, me tul të ëmbël, piqet në maj-qershor.

- Jeton deri 150 vjet dhe ka temperament dritëdashës, duron dhe vendet pak të hijëzuara por jo filizat e rinj. Areali shtrihet nga perëndimi i Evropës deri në Azinë perëndimore. Tek ne gjendet në lartësinë 800-1500 m mbi nivelin e detit. Frutat janë të ngrënshëm, bishtat e frutave përmbajnë hekur dhe mund të përdoren si çaj. Mund të përdoret dhe për pyllëzime.

Acacia dealbata Link – Mimoza
Familja Fabaceae (leguminosae)

- Rritet 10-12 m lartësi por në vendin e origjinës rritet deri në 40 m lartësi. Kurora është rruzullore deri vezake me degë të ngritura përpjetë. Lëvorja është e murrme deri në të hinjtë të errët. Gjethet janë të qëndrueshme, ngjyrë të gjelbër-gri, dyfishpendore. Lulet janë të grupuara në kaptinëza të verdha, në vile të mëdha. Fruti është bishtajë e ngushtë 4-10 cm me ngjyrë gështenje- të murrme. Piqet në korrik-gusht.

- Shumohet me fidanë dhe fara. është lloj karakteristik i klimës subtropikale dhe mesdhetare. Nuk duron temperaturat e ulta dhe sidomos ngricat. Preferon tokat e lehta dhe pjellore. Origjinën e ka nga Tasmania dhe Australia. Tek ne fillimisht është përhapur si lloj dekorativ. Veçori e mimozës është që periudhën e lulëzimit e ka më të herëshme se llojet e tjera që janë në pushim vegjetativ. Meqë nxjerr shumë pinjolla përdoret dhe për forcim shpatesh të rrëshqitëshme. Nuk kërkon shumë përkujdesje.

Albizia julibrissin Durazz. – Albicia
Familja Fabaceae (leguminosae)

- Rritet në trajtë druri të ulët 8-10 m lartësi. Lëvorja është e lëmuar me ngjyrë gri të gjelbërt. Kurora në formë ombrelle. Gjethet janë të rënëshme, deri 20 cm të gjata, dyfishpendore, me 8-12 çifte pendësh. Lulet janë me ngjyrë trëndafili, në kaptinëza rruzullore, në vile skajore, çelin në qershor-gusht. Fruti është bishtajë me damarë të tërthortë të dukshëm, 10-15 cm të gjatë, piqet në nëntor-dhjetor dhe qëndron deri në pranverë.

- Është lloj i klimës së ngrohtë mesdhetare, duron mirë kushtet e qytetit. Origjinën e ka nga Azia dhe Afrika dhe është sjellë në Evropë rreth 1740 nga Frederico Albizzi në Firence dhe mëtej përhapur kudo si specje dekorative prej luleve të bukura dhe kurorës së lehtë. Ka efekt shumë të bukur estetik.

Cercis siliquastrum L – Lofata
Familja Fabaceae (leguminosae)

- **Dru i vogël 8-10 m shpesh dhe si shkurre. Lëvorja është e zezërreme, me plasaritje të imëta gjatësore dhe tërthore. Kurora e çrregullt, gjethet të këmbyera, të thjeshta, veshkore në bazë dhe të rrumbullakosura, me buzë të plota dhe ngjyrë të gjelbër e me bisht deri në 5 cm të gjatë. Lulet janë hermafrodite deri 2 cm të mëdha, në vile, lulëzojnë përpara gjethëzimit në prill-maj dhe me ngjyrë trëndafili. Fruti është bishtajë e zezë-e kuqërrem kur piqet.**

- **Shtrihet deri në lartësinë 800 m mbi nivelin e detit. Duron thatësirën por nuk duron dimrat e ftohtë. Është specie karakteristike e Evropës Jugore dhe Azisë perëndimore. Njihet dhe si druri i Judës. Përdoret për veshjen e terreneve të zhveshura por rëndësi merr për shkak të vlerave dekorative në zonat urbane dhe duruese ndaj ndotjes urbane gjithashtu.**

Ceratonia siliqua L. – Xhixhibanozi
Familja Fabaceae (leguminosae)

- **Dru gjithmonë i gjelbër deri në 10m lartësi. Kurora është e gjerë dhe e dendur. Lëvorja është e murrme-kuqërreme dhe e plasaritur. Gjethet janë të qëndrueshme, të lëkurta të këmbyera, të përbëra çifpendore, 10-20 cm të gjata, me buzë të plota, me ngjyrë të gjelbër të errët. është bimë dioike. Lulet janë shumë të vogla, njëseksore ose vile të vogla, çelin në maj-nëntor. Fruti është bishtajë e madhe 10-15 cm, e lëkurtë dhe e varur me ngjyrë të murrme-manjolë.**

- **Është lloj dritëdashës, preferon tokat e bregdetit dhe vendet e thata deri në lartësinë 600 m mbi nivelin e detit. Origjinën e ka nga Mesdheu Lindor ndërsa në vendin tonë është i përhapur në bregdetin e Shqipërisë Jugore. Mund të përdoret dhe për veshjen e terreneve të thata bregdetare por vlera të shumta ka dhe si specie dekorative për parqe e lulishte.**



Robinia pseudoacacia L. – Robinia
Familja Fabaceae (leguminosae)

- **Në kushte të favorshme arrin lartësi deri në 30 m. Ka system rrënjor shumë të zhvilluar si atë boshtor dhe rrënjët anësore sipërfaqësore gjithashtu duke u shtrirë deri në 20 m distancë. Drurët e vetmuar kërcelli është i shtrembër dhe me nyje. Lëvorja është gri-e murrme, me të çara të thella gjatësore. Kurora është e gjerë, e rrallë, shumë e ndriçuar dhe hijëzon dobët. Bisqet i ka me shumë gjemba. Gjethet janë të përbëra tekpendore, 20-35 cm të gjata, të gjelbra nga sipër, ndajgjethëzat janë të transformuara në gjemba deri 2 cm të gjatë. Lulet janë të bardha, aromatike, të grupuara në vile 10-25 cm të gjata. Fruti është bishtajë çahëse, e murrme-e kuqe.**

- **Rritet mjaft shpejt, deri në moshën 5 vjeçare kalon 10 m lartësi. Ka temperament dritëdashës, nuk pëlqen tokat argjilore dhe gëlqerore, nuk pëlqen lagështinë e tepërt. Origjina nga Amerika e Veriut. Tek ne përdoret shumë për veshjen e terreneve të eroduara por eshe në parqe për arsye dekorative. Sistemi rrënjor i saj pasuron shumë mirë tokën me azot.**



Wisteria sinensis (Sims) – Lulevile kineze
Familja Fabaceae (leguminosae)

- **Është bimë kacavjerrëse me kërcell deri 20 m të gjatë. Lëvorja gri e murrme. Gjethet janë të rënëshme, të këmbyera, të përbëra tekpendore deri 30 cm. Lulet janë të kaltra-vjollcë (mavi) ndonjëherë të bardha, erëkëndëshme, të grupuara në vile, të varura dhe lulëzojnë para gjëthëzimit (prill-qershor). Fruti është bishtajë 10-15 cm, e fortë, e lëkurtë, joçahëse më push si të kadife.**

- **Origjina është nga Kina. Lloj dritëdashës dhe me kërkesa ndaj tokës. Ka rritjë të shpejtë por duhet mbajtur parasysh se lulëzon pas rreth 10 ose më shumë vitesh. Përshkak se ka lule mjaltuese afron shumë insekte, gjithashtu është dhe helmuese si bimë. Por për shkak të bukurisë që merr në periudhën e lulëzimit është mjaft e preferueshme nga ana dekorative. Kërkon përkujdesje.**

Colutea arborescens L –Fshikakarta
Familja Fabaceae (leguminosae)

- **Rritet si shkurre deri në 4 m lartësi. Lëvorja e zezërrem dhe rripet në rripa gjatësorë. Gjethet i ka të rënëshme, të përbëra tekpendore, 5-15 cm të gjata. Lulet janë të verdha të grupuara në vile dhe të ngritura përpjetë. Çelin herët dhe rrinë gjatë gjithëverës. Fruti është bishtajë dhe mbetet në bisk gjatë dimrit.**

- **Është lloj rezistent ndaj thatësirës por vuan të ftohtin e dimrit. Pak kërkues ndaj kushteve të tokës. Origjinën e ka nga Evropa Jugore dhe Afrika Veriore. Tek ne gjendet në zonën e tafinës dhe të gështenjës sidomos në shpatet e diellëzuara pasi është specie dritëdashëse. Mund të përdoret për veshjen e terreneve të eroduara, të thata por dhe si specie dekorative vendase ka mjaft vlera prej luleve dhe frutit që ka.**

Amorpha fruticosa L. – Skërbulli
Familja Fabaceae (leguminosae)

- **Rritet në trajtë shkurreje, 1-3 m lartësi. Kërcell i degëzuar, ka system rrënjor të zhvilluar, të shtrirë shumë anash. Gjethet janë të këmbyera, të përbëra tekpendore, deri në 30 cm të gjata, të rrumbullakosura, gjehtëzon vonë në fund të majit. Lulet janë të vogla me ngjyrë kalter-vjollcë, në kallinj skajorë e të ngritur përpjetë, 10-20 cm të gjatë. Fruti bishtajë e vogël, lehtësisht e harkuar, joçahëse.**

- **Preferon klimën e ngrohtë pa ngrica. Mbin mirë në terrene të eroduara, në toka ranore dhe vende që përmbyten. është specie pushtuese dhe ndojeherë tregon shkallën e lartë të degradimit të mjedisit. Origjina është nga pjesa jugore e Amerikës së Veriut. Tek ne takohet në zona fushore dhe parqe. Përdoret për konsolidimin e terreneve të eroduara.**



Ailanthus altissima (Mill) Swingle– Arra e hindit
Familja - Simarubaceae

- Dru që rritet deri 30 m lartësi. Lëvorja është e lëmuar me ngjyrë të hinjtë, me plasaritje të imëta të batrdhëreme, me erë të keqe. Gjethet janë të rënëshme të këmbyera, të përbëra tekpendore, 40 – 100 cm gjata. Lulet janë hermafrodite ose njëseksore, të gjelbra të verdhërreme, në melthe skajore deri 20 cm të gjata. Fruti shojzë njëflatërshe, 3-4 cm e gjatë, piqet në shtator dhe qëndron gjatë gjithë dimrit.
- Ka rritje të shpejtë por nuk jeton gjatë dhe shumëzohet lehtësisht. Gjen kushte të mira klimatike në zonën e dafinës. Nuk ka kërkesa ndaj tokës, është lloj pionier dhe dritëdashës. Origjinën e ka nga kina ndërsa në Evropë është futur rreth vitit 1960. Përdoret në shpatet e eroduara dhe gjelërimin e zonave industriale meqënëse i reziston tymit dhe gazrave. Nga ana dekorative ka gjithashtu mjaft vlera.

Rhus coriaria (L) – *Shqemja*
Familja – Anacardiaceae- Shqemore

- Shkurre 2-3 m, druri me ngjyrë të kuqe, të celur, i butë, i lehtë. Bisqet i ka të trashë, të murrmë dhe me qime, sythat janë rruzullorë të vegjël, me push kadife. Gjethe i ka të këmbyera, të përbëra, tek pendore, me 5-7 çifte gjethëzash, vezake dhe me buzë të dhëmbëzuara, pak a shumë të lëkurta, në vjeshtë marrin ngjyrë të kuqërremtë. Lulet janë të vogla, të bardha– të gjelbërreme, në melthe dhe në skaj të bisqeve, çelin prill-gusht. Fruti bërthokël rruzullore me ngjyrë të murrme, të purport, shije të athët dhe me push. Fruti përdoret si erëz, piqet tetor-dhjetor. Vaji i nxjerrë nga farat mund të përdoret për të prodhuar qirinj.
- Është pemë vendase e Evropës Jugore. është lloj i klimës mesdhetare, dritëdashës, nuk ka kërkesa ndaj tokës. Tek ne takohet në formacionet shkurrore deri 500 m mbi nivelin e detit. Vlerë ka dhe gjethja e saj sepse nxirret taninë.

Acer pseudoplatanus L - *Panja e malit*
Familja Sapindaceae/Aceraceae - Panjore

- Arrin 30 – 40 m lartësi, sistem rrënjor boshtor . Lëvorja e hinjtë ose gri në rini më pas merr një ritidom të murrmë- të verdhërreme, rripet në pllaka. Gjethet janë të thjeshta, të vrigulluara, pëllëmbore, të rënëshme, me 5 vriguj të mprehtë, me bisht të gjatë 5-15 cm. Lulet janë poligame, në vile të varura, dalin pas gjethëzimit, të gjelbra-verdhërreme. Fruti dyshojzë 3-6 cm, me flatra në formë V, piqen në shtator.
- Panja e malit bën pjesë në llojet me rritje të shpejtë. Rritet në krahina malore të freskëta, me lagështi atmosferike të lartë, duron klimën e nxehtë kur është e vendosur mirë (në hije). Ka kërkesa të larta ndaj tokës. Ka temperament mesatar por më tepër dritëdashës. Është i përhapur në gjithë Evropën dhe Azinë Perëndimore. Emri acer nga latinishtja dmth "e mprehtë" dhe pseudoplatanus dmth "rrap i rremë". Tek ne takohet në zonën e ahut rrallë në zonën e gështenjës. Mund të përdoret dhe si brez mbrojtës (erë, erozion etj).



Acer obtusatum Waldst. et Kit. -Panja fletëgjerë

Familja Sapindaceae/Aceraceae - Panjore

- **E ngjashme me panjën e malit, lartësi 20 m. Bisqet ngjyrë ulliri. Gjethet në formë e madhësi të ndryshme, me shumë qime, me push në faqen e poshtme, me 5 vriguj, me majë shyte, të rënëshme. Lulet me ngjyrë të verdhë limoni, në vastakë, çelin në prill-maj. Fruti dyshojzë me flatra të gjata, ose gjysëm rrethore. Rritet shpejt, ka aftësi lastarizuese të madhe.**
- **Preferon klimën e zonës së gështenjës dhe të ahut, toka pjellore. Rrezistent ndaj thatësirës, ka temperament dritëdashës. Gjendet kryesisht në Ballkan, Siçili dhe Korsikë. Tek ne gjendet kryesisht në zonën e gështenjës**



Acer platanoides L – Panja fletërrap

Familja Sapindaceae/Aceraceae - Panjore

- **Është dru i madh, i ngjashëm me panjën e malit. Sistem rrënjor sipërfaqësor si panja e malit. Lëvore në rini me ngjyrë të hinjtë të murrme, plasaritet për së gjati. Gjethet të thjeshta, të rënëshme, të përkundrejta, të mëdha me 5 – 7 vriguj me majë dhe buzë të dhëmbëzuara mprehtë, me bisht deri 15 cm, kthehen të verdha-portokalli në vjeshtë. Lulet janë poligame, të verdha-të gjelbra, në vastakë të ngritur përpjetë. Fruti dyshojzë me fara të shtypura, formojnë kënd pothuaj të shtrirë.**
- **Në moshë të re ka rritje të shpejtë. Përshtatet me klimën kontinentale, preferon toka pjellore. Ka periudhë pushimi vegjetativ më të gjatë se panja e malit, prandaj iu rreziston dhe ngricave të vonshme. Tolerant ndaj hijes, ndotjes urbane. Jeton gjatë (rreth 300 vjet). Areali i saj është mjaft i gjërë por tek ne takohet rrallë në zonën e ahut.**



Acer campestre L- Krekëza fletëmadhe

Familja Sapindaceae/Aceraceae - Panjore

- **Lartësi më të vogël se panjat e tjera, rreth 15 m. Kërcelli shpesh i shtrembër. Lëvorja me ngjyrë të hinjtë deri të murrme, formon një ritidom të trashë të thyeshëm, me të çara të holla, të çrregullta, me njolla të bardhërreme. Gjethet janë të vogla me 5 vriguj, zakonisht janë shyte dhe të rrumbullakosura, me buzë të plota ose të vrigulluara, nga poshtë me push, me bisht 2-5 cm. Lulet janë të verdha- të gjelbra, në vile përpjetë. Fruti është dyshojzë me fara të shtypura, formon kënd 180°.**
- **Ka kërkesa ndaj nxehtësisë, kërkon toka të formuara mbi shkëmbinj gëlqerorë. Është lloj i përhapur në Evropën Perëndimore, pjesën Qendrore të Rusisë, Azi e Vogel dhe Iran. Tek ne takohet në zonën e dafinës dhe të gështenjës.**



Acer monspessulanum L-Krekëza fletëvogël

Familja Sapindaceae/Aceraceae - Panjore

- **Dru i vogël që arrin 6 – 12 m mesatarisht, shpesh si shkurre. Kërcell i shtrembër, degëzohet që nga baza. Gjethet të thjeshta, të përkundrejta, të vogla 3-6 cm, pëllëmbore me tre vriguj me buzë të plota dhe majë shyte, me bisht 2-6 cm. Lulet janë poligame, në vastakë skajorë. Çelin në të njëjtën kohë me gjethëzim ose përpara. Frutat janë të varura, dyshojza të shogëta, 2-3 cm, me flatra pothuajse paralel, piqen në shtator.**

- **Është lloj dritëdashës, termofil, preferon kundrejtimet e diellëzuara dhe tokat e thata dhe gëlqerore. Origjinën e ka nga Evropa Jugore, Azia e Vogël, Afrika e Veriut. Tek ne takohet në zonën e dafinës deri tek e gështenjës, terren të thata. Nga ana dekorative ka vlera të veçanta prej frutit, sikurse mund të përdoren mjaft mirë për veshjen e terreneve të thata e shkëmbore duke formuar tufa që mbrojnë dhe përmirësojnë tokën.**



Acer tataricum L – Ulëza

Familja Sapindaceae/Aceraceae - Panjore

- **Rritet në trajtë shkurreje, jo më shumë se 10 m. Lëvorja e lëmuar, e hinjtë e mbyllur. Bisqet të hollë të murrmë të kuqërremtë, të shogët. Gjethet janë të përkundrejta, vezake, të zgjatura, 5-10 cm të mëdha, me majë të mprehtë, me buzë dyfish të sharruara, në vjeshtë marrin ngjyrë të kuqe dekorative. Lulet janë të bardha, të gjelbra, në grupe sëbashku, në melthe, dalin pas gjethëzimit. Fruti dyshojzë e shogët, të kuqe të purput në verë, flatrat janë paralele.**

- **Ulëza ka kërkesa të mëdha ndaj nxehtësisë (mezokserofite) se krekëza fletemadhe, por toleron ndaj pjellorisë së tokës. Ka areal të kufizuar, në Evropë dhe në Azi. Tek ne i përhapur në zonën e gështenjës dhe rralë në zonën e dafinës. Dhe si lloj dekorativ ka mjaft vlera prej ngjyrimit që merr.**



Acer negundo L – Panja fletëfrashër

Familja Sapindaceae/Aceraceae - Panjore

- **Dru me shtat të shkurtër. Lëvorja e hollë me ngjyrë gështenjë të çelur. Gjethet të përbëra tekpendore, me 3-7 gjethëza, me forma të ndryshme, me buzë sharruar çrregullt ndërsa gjethja e majës me 3 vriguj. Bimë dioike, me lule të gjelbra-verdhërreme, lulet mashkullore të vendosura në tufëza, femëroret në vile të varura, çelin para gjethëzimit. Fruti është dyshojzë e hinjtë e bardhërreme, me flatra afërsisht paralele, harkuar nga brenda, piqet në gusht.**

- **Ka pak kërkesa ndaj tokës, klimës. Me origjinë nga Amerika e Veriut, e ardhur që në vitin 1688 në Evropë. Tek ne takohet e mbjellë në parqe dhe rrugë si dru zbukurues, ka rritje të shpejtë. Mund të përdoret dhe për veshjen e terreneve të degraduara.**



Aesculus hippocastanum L - Gështenja e kalit
Familja Hippocastanaceae

- **Arrin deri 25 m lartësi. Ekzemplarët e vetmuar kanë kërcell të shkurtër dhe shumë të degëzuar, sistemi rrënjor shumë i zhvilluar. Lëvorja e hinjtë e zezërreme deri e murrme. Kurora e dendur, rruzullore, e gjerë. Gjethet janë të përkundrejta, të gjerë, me bisht të gjatë deri 20 cm, të përbëra pëllëmbore, me 5-7 gjethëza pa bisht, vezake, të përmbysura, buzë të sharruara çrregullt, ngjyra e gjelbër nga sipër dhe poshtë me ngjyrë ndryshku dhe qime. Lulet janë dyseksore, në vile të mëdha shumëlulëshe, të ngritura përpjetë, 20-30 cm. Fruti është kapsulë sferike, , mishtake e verdhe-e gjelbërreme, me gjemba të mëdhenj shpues, hapet më dysh ose tresh dhe brenda ka kokrra të ngjashme me gështenjën e butë.**

- **Preferon klimë të butë , toka gëlqerore, është rrezistente ndaj ngricave, me temperament gjysëm dritëdashës. Ripërtërihet me farë dhe lastarë. Origjina nga Azia e Vogël, Gadishulli Ballkanik. Ka vlera si dru zbukurues në zona urbane për hijen e dendur. Hippocastanum dmth gështenjë kali.**



Ilex aquifolium L – Ashia
Familja Aquifoliaceae

- **Dru i vogël, shpesh si shkurre. Degë të shtrira e të holla. Lëvorja e lëmuar dhe e shogët. Gjethet janë të qëndrueshme, të këmbyera, të thjeshta, polimorfe, me bisht të shkurtër, vezake-eliptike, buzët të valëzuara, gjembore, të shndritëshme nga sipër, të lëkurta. Bimë dioike, lule të vetmuara ose në tufëza sqetullore, të vogla dhe me bisht të shkurtër, çelin prill-qershor. Fruti rrushk, vezak, me thumb në majë, me bisht, i tultë, ngjyrë të kuqe të ndezur, piqet shtator-nëntor por qëndron deri në pranverë.**

- **Lloj hijedashës dhe nxehtësidashës, pa kërkesa të mëdha për tokën. Përhapur në Evropën Qëndrore, Jugore, Afrikë Veriore. Shkurre zbukuruese e preferueshme për shkak të qëndrueshmërisë së gjetheve dhe frutave të saj.**

Euonymus europaeus L- Fshikakuqi i rëndomtë
Familja Celastraceae

- **Shkurre që arrin 6 m, gjetherënëse. Bisqet janë të gjelbër, me seksion katërkëndor. Gjethet janë të gjata heshtake ose vezake eliptike, 3-10 cm, të ngushta në bazë, me buzë ura ura, të sharruara, me bisht. Lulet janë hermafrodite, të plota, të gjelbra të verdha, të vendosura në sqetullën e gjethes. Lulëzon prill-maj. Fruti kapsulë, me 4 vriguj të rrumbullakosur, ngjyrë të kuqe-çiklami ose trëndafili, piqen shtator-nëntor.**

- **Ka kërkesa ndaj dritës dhe nxehtësisë gjatë periudhës së vegjetacionit, i rreziston thatësirës. Origjinën e ka nga Evropa dhe Azia Perëndimore. Tek ne gjendet në zonën e dafinës dhe të gështenjës deri në lartësinë 1300 m mbi nivelin e detit. Shumëzohet lehtësisht me farë. Mund të përdoret si pjesë e dizajnit urban si skemë e mbjelljeve me bimësi vendase. Kërkon pak mirëmbajtje.**



Euonymus verrucasus Scop- Fshikakuqi lythe lythe

Familja Celastraceae

- **Përmasa të vogla 2-3 m. Bisqet janë karakteristike të gjelbër, të hollë, me verrukozitete. Gjethet të përkundrejta, vezake heshtake ose eliptike të zgjatura, të sharruara ura rua imët, me bisht të shkurtër. Lulet janë të plota, me bisht, në grupe deri në 3. Fruti kapsulë, ngjyrë trëndafili.**
- **Preferon vendet e hijëzuara dhe me lagështi të mjaftueshme. Aerali është evropian dhe aziatik.**



Buxus sempervis L- Bushi

Familja Buxaceae

- **Zakonisht mbetet një shkurre kaçubore. Gjethet i ka të qëndrueshme, të përkundrejta, të thjeshta, vezake-eliptike, të lëkurta, me buzë të plota, me erë të rëndë. Lulet janë të vogla, të verdha dhe pak të dukshme, çelin mars-maj. Fruti kapsulë rruzullore me 3 qoshëza, piqet korrik-gusht.**
- **Gjendet në vende gurishtore të diellëzuara nga bregdeti deri në zonat malore. Duron shumë mirë hijëzimin dhe thatësirën. Areali i saj është në Evropën Qëndrore, Jugore dhe në Afrikën Veriore deri në Azinë e Vogël. Tek ne rritet deri në lartësinë 1300 m mbi nivelin e detit. Ka rritje të avashtë. Mbillet si lloj dekorativ për shkak të gardheve që krijon dhe si shkurre përherëblertë.**



Paliurus spina-Christi Mill- Driza

Familja Rhamnaceae

- **Shkurre 2-3 m. Lëvore e lëmuar me ngjyrë hiri. Kërcelli dhe degët janë të përkulura. Bisqet janë të paisur me dy gjemba anash sythit, njëri i drejtë dhe më i gjatë dhe tjetri më i shkurtër dhe i përkulur. Gjethet janë të rënëshme, të vendosura në mënyrë distike, me bisht të shkurtër 2-4 cm asimetrike, vezake, shyte në majë dhe të rrumbullakosura në bazë, të sharruar shumë imët, ura ura ose të plota, me 3 nervatura. Lulet janë të verdhërreme, të vogla, të grupuara, sqetullore. Fruti është shojzë rrethore, e thatë e verdhëreme dhe fara e vendosur në mes të flatrës, piqet në korrik-gusht.**
- **Lloj kryesisht mesdhetar, kserofil, termofil, pa kërkesa ndaj tokës. Tek ne gjendet deri në lartësinë 700 m mbi nivelin e detit. Përdoret kryesisht për ndërtimin e gardheve të gjallë.**



Rhamnus fallax Boiss - *Arrçi*
Familja Rhamnaceae

- **Shkurre 2-5 m. Gjethet të rënëshme, vezake ose eliptike, të zgjatura, buzë të dhëmbëzuara imët, dhe me bazë të rrumbullakosur ose si zemër, me 12-18 çifte nervaturash. Lulet të gjelbra-verdhërreme, në grupe 3-7, çelin maj-qershor. Fruti kokërr gati rruzullore, 0.5 cm, ngjyrë e zezë, piqet korrik-shtator.**

- **Lloj i klimës malore, duron hijëzimin, mbin mbi çdo lloj toke por preferon vendet me lagështirë, buzë lumenjëve. Gjendet në krahinat malore të Evropës Juglindore. Mund të përdoret dhe si lloj zbukurues në parqe.**

Rhamnus alaternus L – Beloti
Familja Rhamnaceae

- **Në trajtë druri 8-10 m lartësi. Gjethet i ka të qëndrueshme, të thjeshta, të këmbyera, të lëkurta, në formë vezake-heshtake, të mprehta, me buzë të sharruara imët, me majë shpuese. Gjethja ka ngjyrë të gjelbër sipër dhe nervaturë të mesit të dukshme dhe anësoret që arrijnë deri në mes. Bimë dioike, lulet në vile të dendura, pa bisht, sqetullore, dalin në prill-maj, erëkëndëshme. Frutat bërthokla rruzullore sa një bizele, të zeza në pjekuri, piqen korrik-shtator.**

- **Lloj dritëdashës, nxehtësidashës. Takohet në zonën e dafinës, i përhapur nga Spanja deri në Krime e Afrikë Veriore. Preferohet gjerësisht për shkak të gjetheve të bukura që i mban gjatë gjithë vitit.**



Rhamnus cathartica L – *Pjerrza dliruese*
Familja Rhamnaceae

- **Shkurre 2-3 m, gjetherënëse, lëvorja e murrme, e ashpër dhe në formë unazash. Bisqet të hinjtë, të shogët, të shndritshëm. Gjethet janë vezake-eliptike, 4-8 cm. Me majë të mprehtë ose shyte, buzë sharuara ura ura, me çifte nervaturash të dukshme, me bish 1-4 cm. Bimë poligame ose dioike. Lulet janë të vogla, të gjelbra-të verdhërreme, në grupe sqetullore, çelin maj-qershor. Frutat janë bërthokla të zeza, të rrumbullakta, piqen gusht-shtator.**

- **Është lloj gjysëm termofil, rezistent ndaj thatësirës dhe të ftohtit të dimrit. Gjendet në të gjithë Evropën, Algjeri, Azinë e Vogël.**

Rhamnus tinctorius W et. K – Pjerrza ngjyruese
Familja Rhamnaceae

- **Shkurre 1- 2 m me kërcej (bisqe) të ngritur përpjetë. Gjethet janë vezake të përmbysura deri heshtake, me 2-3 palë nervatura. Lulet janë të gjelbra-verdha, mbajnë erë të keqe. Fruti kokërr ngjyrë e zezë , e shndritëshme.**
- **E përhapur në Evropën Juglindore, pak në atë Qëndrore, tek ne gjendet në lartësi të mëdha mbi nivelin e detit.**

Frangula alnus Mill. – Zogla e rëndomtë
Familja Rhamnaceae

- **Shkurre ose dru i vogël 3-7 m, më shpesh si shkurre. Bisqet të ngritur përpjetë, lëvorja e lëmuar. Gjethet janë të thjeshta, të këmbyera, me bisht të shkurtër deri 3 cm, me buzë të plota, një nervaturë kryesore dhe 7-9 çifte nervaturash dytësore, të shndritëshme. Lulet janë hermaphrodite, të gjelbra-bardhërreme, sqetullore, lulëzon maj-korrik. Fruti bërthokël rruzullore, e gjelbër në fillim pastaj e kuqe deri në të zezë kur piqet në korrik-shtator.**
- **Ka kërkesa ndaj lagështirës së tokës. I reziston hijëzimit, rritje të ngadaltë. Përhapur gjerësisht në Evropë dhe Azi të Vogël. Lëvorja përdoret në farmaceutikë, frutat përmbajnë sheqer, vitamin C dhe lëndë ngjyruese. Në kulturën pyjore mund të përdoret si element për vlerësim të vendeve të lagëta në pyje.**



Parthenocissus quinquefolia L – Hardhia kanadeze
Familja Vitaceae

- **Shkurre kacavjerrëse me degëzime të shumta, disa herë e paisur me rrënjë adventive (ajrore) që ngjiten 20-30 m pas mureve. Gjethet janë pëllëmbore, të rënëshme, me 5 gjethëza, 5-10 cm të gjata, të sharruara ura ura, në vjeshtë marrin ngjyrë të kuqe. Lulet janë të verdhërreme, në vastakë melthore, çelin në korrik-gusht. Fruti rrushk me ngjyrë të zezë-blu, piqet gusht-shtator.**
- **Origjina është nga Amerika e Veriut. Tek ne gjendet si specie zbukuruese. Pak kërkuese ndaj kushteve të tokës, klimës, kultivohet me lehtësi me farë dhe kalema. Vlerësohet nga ana dekorative për shkak të gjethes së bukur dhe maskimin e mureve rrethues.**

Tilia platyphyllos Scop – Bliri fletëgjërë
Familja Tiliaceae

- **Dru që arrin 30 m. Kërcell i drejtë, lëvore gri e lëmuar në fillim pastaj me të çara gjatësore. Druri pak i qëndrueshëm, preket nga krimbat. Kurora e gjërë. Gjethet të mëdha deri 10 cm x 8 cm, të vendosura në mënyrë distike, buzë të sharruara mprehtë, të gjelbra në të dy faqet, me push kadife nga poshtë, me bisht. Lulet janë në lulesa, shumë erëkëndëshme, çelin në qershor. Fruti aken, me qime , me 4-5 brinjëza, të forta, piqet në qershor-korrik.**

- **Takohet në zonën e gështenjës dhe të ahut. Preferon toka të freskëta dhe të thella. Bliri fletëgjërë është tregues i pjellorisë së tokës. Është bimë pak e shoqërueshme. E përhapur në Evropë Qëndrore, Jugore. Lulet dhe farat kanë vlerë mjeksore, përdoren dhe si çaj. Tek ne takohet deri në lartësinë 1500 m mbi nivelin e detit. Ana dekorative është një pikë e fortë e kësaj specie, ka kurorë të bukur dhe shumë aromatik. Nuk kërkon shumë përkujdesje dhe krasitja është mirë të bëhet gjatë periudhës së gjumit.**



Tilia Tomentosa Moench- Bliri fletëargjentë
Familja Tiliaceae

- **Arrin lartësi 30 m, kërcell i drejtë. Kurora e gjerë, ka një ngjyrim si të argjentë, lëvorja e lëmuar për shumë kohë. Gjethet janë 7-13 cm të mëdha, afërsisht si zemër, me majë të mprehtë, nga sipër të gjelbra, poshtë të argjenda ose të hinjta, bishti me push. Lulet janë në lulesa të varura, në levare, pa bisht ose me bisht të shkurtër, me erë të këndëshme, lulëzon në qershor. Frutat janë akene, me mure të forta, me 5 brinjëza ose të lëmuar, piqen në shtator.**

- **Ka rritje aktive, është lloj termofil, ka kërkesa ndaj tokës, duron thatësirën. I përhapur në Azinë e Vogël, Evropën Juglindore. Tek ne takohet shpesh në zona kodrinore dhe malore të zones së dafinës. Lulet shërbejnë për bletari ose në mjeksi. Mbillet shpesh si dru dekorativ buzë rrugëve.**



Hibiscus syriacus L - Hibisku
Familja Malvaceae

- **Shkurre që arrin 3 m lartësi. Kërcelli i degëzuar nga baza duke formuar një tufë të ngjeshur. Gjethet janë të këmbyera, vezake ose rombike-vezake, 5-12 cm të gjata, trevrigullore dhe të dhëmbëzuara çrregullt me 3 nervatura pëllëmbore. Lulet janë hermaphrodite, të vetmuara, të mëdha, deri në 6 cm, me petal të bardha dhe njolla të kuqe-manushaqe dhe shumë thekë, lulëzon në korrik-shtator. Fruti është kapsulë çahëse me kthina, piqet tetor-nëntor. Lastaron dhe shumëzohet me lehtësi me fara dhe me kalema.**

- **I përshtatet thatësirës dhe të ftohtit, ka pak kërkesa ndaj tokës. Me temperament dritëdashës por duron edhe pak hijëzim. Origjinën e ka nga Azia e Vogël, Irani dhe Kina. Tek ne takohet si bimë zbukuruese e parqeve dhe lulishteve. Ka shumë varietete të saj.**

Hippophae rhamnoides L – *Hipofaja*
Familja Elaegnaceae

- **Është shkurre kaçubore, zakonisht me lartësi 2-3m. Sistem rrënjor kaçubor, shumë të shtrirë anash, rrënëjt kanë disa të fryra të dukshme që shfrytësohen për të kapur azotin atmosferik. Bisqet vjetorë mëllugorë, ato anësorë me gjemba të shumtë dhe tepër të fortë. Gjethet janë të këmbyera, vezake-heshtake, me buzë të plota, nga poshtë me qime të hinjta të argjenta. është bimë dioike, lulet janë shumë të vogla, mashkulloret në lulesa rruzullore, femëroret kanë shtrat lulor të dukshëm, në vile në trajtë kalliri, çelin herët në mars prill, para gjethëzimit. Frutifikon çdo vit por me bollëk njëherë në dy vjet. Frutat të shndritshme, në majë të bisqeve dy vjeçare ku qëndrojnë gjatë gjithë dimrit.**

- **Duron të ftohtin e madh të dimrit gjithashtu dhe nxehtësinë e madhe gjatë verës. Në mjaft vende përdoret për konsolidimin e terreneve të erroduara, rrëshqitëse. Është lloj euroaziatik, tek ne duhet të përhapet më tepër për shkak të rëndësisë që paraqet dhe si bimë dekorative.**

Elaeagnus angustifolia L – *Hunapi*
Familja Elaegnaceae

- **Në trajtë shkurreje deri në 7 m, kërcell të çrregullt, bisqe gjembore. Gjethet me bisht të shkurtër, heshtake të zgjatura, 4-8 cm të gjata, të mprehta ose shyte, të gjelbra të hinjta nga sipër dhe të argjenda të shndritshme nga poshtë. Lulet janë hermaphrodite ose poligame, të vetmuara ose 2-3 sëbashku, janë erëkëndëshme dhe çelin në prill. Fruti bërthokël e rreme elipsoidale, e verdhë-porokalli, me tul të ëmbël, i ngrënshëm, piqet shtato-tetor.**

- **Është lloj i klimës së ngrohtë, rrezistent ndaj thatësirës dhe të ftohtit, me temperament dritëdashës, rritet në toka ranore madje dhe ato të kripura. Rrezistent ndaj tymit, gazrave industrial. Fikson terrene të paqëndrueshëm. Në mënyrë spontane është hapur në Evropën Juglindore dhe Azinë Perëndimore. Tek ne takohet në kopshte e lulishte.**

Tamarix parviflora DC – *Marina*
Familja Tamaricaceae

- **Shkurre karakteristike e ranishteve të lumenjëve, 3-4 m lartësi. Degët me lëvore ngjyrë të murrme-purpurt. Gjethet në trajtë mëllugash, vizake-heshtake 1-2 mm. Lulet në trajtë kallinjsh, ngjyrë trëndafili të hapur, çelin në prill-maj. Fruti është kapsulë me ngjyrë vjollcë, piqet korrik-gusht.**

- **Është lloj i klimës mesdhetare, mbin në toka të lehta me rërë. Në mënyrë spontane takohet vetëm në Gadishullin Ballkanik, e kultivuar gati në gjithë Evropën Qëndrore e Jugore. Tek ne takohet dendur në bregun e lumenjëve dhe zonave bregdetare. Si shkurre zbukuruese ka vlera të veçanta për shkak të ngjyrimit që ofron.**

Tamarix dalmaticum Baum. – Marina e Dalmacisë

Familja Tamaricaceae

- **Rritet në trajtë shkurreje ose dru i vogël 6-7 m. Gjethet i ka si mëlluga, 2-4 mm, me ngjyrë qielli në të gjelbër. Lulet që formohen në degët dyvjeçare janë në lulesa 2-6 cm të gjata, çelin në qershor – gusht. Frutat janë kapsula piramidale.**
- **Gjen kushte të përshtatshme klimaterike në zonën e lauretum, mbillet më tepër me kalema. Nuk ka shumë kërkesa për tokën por preferon ato kënetore, ranore dhe pak të kripura. Përdoret dhe si shkurre zbukuruese.**

Lagerstromia indica L. – Lagestromia

Familja e Lythraceae - Litrore

- **Shkurre ose dru i vogël , 7-8 m lartësi. Kurorë e bukur me degë të holla. Tek ekzemplarët e vjetër merr formë çadre. Bisqet i ka të lëmuar, degët e kurorës dhe kërcejt janë dredha dredha, drurët e vjetër me lëvore të hollë, të lëmuar, me ngjyrë të hinjtë-kafe e hapur pak në nuancë trëndafili. Gjethet me bisht të shkurtër eliptike, ose vezake të përmbysura, të zgjatura, 2-7 cm të mëdha, të lëmuara, të lëkurta, të gjelbra dhe në vjeshtë marrin ngjyrë portokalli – të kuqe ose të purpurt. Lulet të mëdha, ngjyrë trëndafili, rrallë të bardha, në melthe të mëdhenj deri 20 cm të gjata. Lulëzimi fillon në fund qershor deri në shtator. Frutat janë kapsula elipsoidalë, piqet tetor-nëntor.**
- **Nuk ka kërkesa për tokën, duron vendet gjysmë të hijëzuara. Origjinën e ka nga India. Tek ne takohet në lulishte e parqe, sidomos ato bregdetare.**

Myrtus communis L. – Mërsina

Familja Myrtaceae

- **Dru i vogël deri 10 m max. Zakonisht rritet si shkurre gjithmonë e gjelbër, e dendur, shumë e degëzuar. Lëvorja e kuqërremtë pastaj gri e hinjtë. Gjethet janë të thjeshta, të përkundrejta ose në qerthuj, të pabishta, vezake-heshtake, të thepta në majë, ngjyrë e gjelbër-errët, shumë erëkëndëshme. Lulet janë hermafrodite, të vetmuara, ose nga dy sëbashku, sqetullore, çelin korrik-tetor, me pjalmore të verdha. Fruti është rrushk me ngjyrë të errët, me shijë të ëmbël ,piqet në nentor.**
- **Është lloj dritëdashës, nxehtësidashës, i përhapur në zonën e shkurreve mesdhetare gjithmonë të gjelbra. Shumëzohet kryesisht me farë, rritet ngadalë. është e përhapur në bregdetin e Evropës Jugore, Azinë Perëndimore, dhe Afrikën Veriore. Druri dhe gjethet e mërsinës gjejnë përdorime të ndryshme**

Eucalyptus camaldulensis Dehnh. – Eukalipti
Familja Myrtaceae

- **Arrin lartësi 20 m mesatarisht, kërcell të drejtë, kurorë rruzullore. Druri me ngjyrë të kuqe të errët, duron përdredhjen por pëson çarje. Lëvorja është e lëmuar me ngjyrë gri me reflekse të argjenda pastaj me ngjyrë të errët, rripet çdo vit. Bisqet janë të kuqërremtë. Gjethet janë të këmbyera, me bisht, të lëkurta, shumë aromatike, heshtake-koserake, 12-22 cm të gjata. Lulet janë hermaphrodite, në formë ombrellash, sqetullore, çelin në maj-qershor. Fruti është kapsulë, me bisht, me majë në trajtë sqepi, piqet në janar-mars.**

- **Origjinën e ka nga Australia por i përhapur shumë në Mesdhe. Ka rritje të shpejtë. Përshtatet gati me të gjitha llojet e tokave.**

Eucalyptus globulus Labill. – Eukalipti
Familja Myrtaceae

- **Arrin deri 45 m lartësi, druri është i fortë, i rëndë, ka tendencë të çahet. Lëvorja zhvishet në pllaka të gjata. Gjethet janë të gjata, të përkulura si drapër. Lulet janë të mëdha, të vetmuara ose në grupe, çelin maj-qershor. Fruti është kapsulë që piet në janar-mars.**

- **Përshtatet mirë me tokat me përmbajtje të lartë rëre. Kufizues klimatik i këtij eukalipti është sasia e rreshjeve të rëna të pakta. Ka rritje të shpejtë dhe forma të bukura kërcelli.**

Callistemon viminalis – Kalistemoni (lule zjarri, lule furçë)
Familja Myrtaceae

- **Është një shkurre përherë e gjelbër dhe ka zakonin të hapet shumë kurora. Gjethet i ka pak aromatike, në formë lineare ose pak si heshtë dhe ngjyrim të gjelbër. Lulet janë në formë furçe ose si shishe. Lulet janë hermafrodite me ngjyrë të kuqe dhe direkt pas tyre vijnë frutat që janë kokrra të vogla, të zeza.**

- **Origjinën e ka nga Australia. Emri i saj vjen nga greqishtja e lashtë "kalli"që dmth e bukur dhe "stamen" që është poleni. Kalistemoni toleron mjaft mirë kushtet e tokës. Preferohet shumë për mbjellje në qytet për shkak të efektit të bukur që i japin lulet e saj me ngjyrë të kuqe. Kalistemoni nuk kërkon shumë shërbim mirëmbajtje.**

Punica granatum L. – Shega e egër
Familja Punicaceae

- **Dru i shkurtër ose si shkurre, shumë i degëzuar. Bisqet janë të shogët me kënde dhe gjemborë. Gjethet janë të rënëshme, të thjeshta, më tepër të përkundrejta me bisht të shkurtër, heshtake, me buzë të plota, me ngjyrë të gjelbër të çelët sipër dhe nervatura e mesit e dukshme. Lulet janë hermafrodite, të vetmuara ose në grupe dhe sqetullore, kupa është gypore-këmbanore, me ngjyrë të kuqe të çelët, me pjalmore të verdha, çelin në korrik-tetor. Fruti rrushk i madh rruzullor dhe mishtak, piqet shtator-tetor.**

- **Zhvillohet mirë në zonën e makjes (shkurreve mesdhetare), është dritëdashës dhe nxehtësidashës. Është i përhapur në pellgun perëndimor të Mesdheut dhe Azinë Perëndimore por origjinën e ka nga Irani. Tek ne gjendet zakonisht deri në lartësinë 700m.**



Cornus mas L. – Thana
Familja Cornaceae

- **Rrallë arrin dimensionet e një druri, me degë të holla, ngjyrë të kuqe të murrme, bisqet të ngritur përpjetë. Ka dru të fortë dhe shumë rrezistent. Gjethet janë të thjeshta, të përkundrejta, të rënëshme, me llapë vezake-eliptike, me buzë të plota, ngjyrë të gjelbër, me push nga poshtë, nervatura të dukshme. Lulet janë hermaphrodite, të vogla, të verdha, në bazë kanë një pështjellëse me 4 brakte të verdhërreme, çelin herët në pranverë para gjethëzimit. Fruti është bërthokël vezake e zgjatur, ngjyrë të purpurt të shndritshme, i varur, i athët, i ngrënshëm, piqet në gusht-tetor.**

- **Rritet ngadalë por jeton deri në 100 vjet. Është lloj nxehtësi dashës, preferon shpatet e diellëzuara, toka të lehta, të shkrifta, pjellore. Origjinën e ka nga Evropa Qëndrore dhe Juglindore si dhe Azia e Vogël.**

Cornus sanguniea L. – Thanukla
Familja Cornaceae

- **Shkurre 3-4 m lartësi, druri ka karakteristika si të thanës. Bisqet i ka të shogët, të shndritshëm, ngjyrë të kuqe të purpurt. Gjethet janë eliptike të gjera ose vezake 4-8 cm të gjata, me push në të dy faqet, me nervatura të harkuara në drejtim të majës. Lulet janë të plota, të bardha, ta gjelbërreme, në vastakë ombrellorë, skajorë, çelin pas gjethëzimit në maj-qershor. Fruti është bërthokël rruzullore e zezë, 5-6 mm e madhe, piqet në shtator.**

- **Ka amplitudë ekologjike më të madhe se thana, nuk ka kërkesa ndaj tokës, shpesh prania e thanuklës tregon lagështi të mjaftueshme në tokë. Origjina është Euroaziatike. Ka të njëjtat përdorime si thana. Emërtimin sanguinea e ka marrë prej bisqeve të purpurt që ka.**



Hedera helix L. – Urthi
Familja Arialaceae

- Bimë kacavjerrëse që mund të arrijë deri 20 m lartësi, nqs nuk ka mbështetëse merr trajtën e një shkurreje zvarritëse. Kërcelli dhe bisqet nxjerrin rrënjë adventive me qime thithëse, që kapen pas mureve, drurëve etj. Gjethet janë të qëndrueshme, të këmbyera, ato të bisqeve jo pjellore 4-10 cm të gjata, me 3-5 vriguj trekëndorë, me buzë të plota, të gjelbra, gjethet e bisqeve lulore janë më të pakta në numër, vezake-rombike, të pavrigulluara, dhe me ngjyrë të gjelbër më të hapur. Lulet janë si ombrellë, të bardha-të gjelbra, lulëzon vonë në shtator. Fruti rrushk i zi, piqet në pranverën e ardhëshme. Shumohet me lastarë, kalema.

- Jeton disa qindra vjet, ka amplitudë të gjerë por preferon klimën e ngrohtë. Preferon tokat gëlqerore, i reziston tymrave, dhe hijëzimit. Përhapur në Evropë deri në Kaukaz tek ne gjendet deri në lartësinë 1800 m mbi nivelin e detit. Përdoret mjaft mirë si bimë dekorative për veshje muresh etj.



Erica arborea L. – Shqopa
Familja Ericaceae

- Dru i vogël që në kushte të favorshme arrin deri 6 m lartësi. Gjethet janë vizake, qerthullore, 3-4 sëbashku, të shogëta, shumë të vogla. Lulet janë të grupuara në melthe, me bisht të shkurtër, të bardha ose trëndafili, me kurorë këmbanore, lulëzon mars-maj, lulet janë mjaltore dhe me aromë. Fruti është kapsulë vezake 1-2 mm.

- Është lloj që kërkon nxehtësi dhe dritë, preferon tokat rano-argjilore të thata, kryesisht në zonën e dafinës. Arealin e shtrirjes e ka në Evropën Jugore, Afrikë Lindore dhe Veriore. Tek ne gjendet deri në 700 m mbi nivelin e detit.



Erica herbacea L. – Grathateli
Familja Ericaceae

- Lartësi 20 – 60 cm i lartë, gjithmonë i gjelbër dhe i drunjëzuar, me gjethe pa bisht, në qethuj me 3-5. Lulet i ka të kuqe në ngjyrë mishi, nganjëherë të bardha, në vile anësore. Lulëzon nga shkurti në qershor. Në vendet e ekspozuara lulëzimi zgjat edhe më shumë. Fruti kapsulë e shogët, piqet qershor-korrik.

- Ka temperament dritëdashës, toka ku mbin është ajo e formuar mbi shkëmbinj gëlqerorë serpentinorë dhe e mban tokën shumë të lidhur me anë të sistemit rrënjor.



Arbutus unedo L. – Mareja
Familja Ericaceae

- **Rritet si dru i vogël ose si shkurre gjithmonë e gjelbër. Gjethet janë të qëndrueshme, të trasha, të lëkurta të thjeshta, me bisht të shkurtër, vezake të përmbysura ose vezake-heshtake, buzë të sharruara deri heshtake, me ngjyrë të gjelbër të theksuar, të shogëta. Lulet janë këmbanore, hermafrodite janë të bardha kryesisht, çelin në tetor-mars. Fruti është rrushk i rrumbullakët, i ashpër, me ngjyrë të kuqe të çelët, me tul të verdhë, të lëngshëm, i ngrënshëm, piqet nga tetori-janar.**
- **Është lloj termofil dhe mesatarisht dritëdashës, nuk ka kërkesa të veçanta ndaj tokës por preferon tokat ranore-argjilore. Shtrihet në të gjithë Mesdheun dhe deri në Irlandë. Njëherë që arrin të mbijë, duron mjaft mirë pastaj thatësirën. Preferohet shumë si lloj dekorativ prej gjetheve, luleve dhe frutave të bukura.**



Arbutus andrachne L. – Mellagjeri
Familja Ericaceae

- **Rritet si shkurre 3-4 m e lartë. Lëvorja është e lëmuar, ngjyrë të kuqërremtë, në stinën e verës plasaritet dhe shkëputet në trajtë fijesh të holla. Bisqet i ka të kuq, pa push. Gjethet të qëndrueshme, vezake-eliptike 6-12 cm të gjata, me bisht, me buzë të plota, rrallë me dhëmbë të imët. Lulet janë në melthe, me push të ngjitëshme, ngjyrë të bardhë-gjelbërreme, çelin fund të janarit-prill. Fruti rrushk si kokrra e mares por më i vogël dhe më i forta, ngjyrë portokalli dhe i hidhur, piqen në vjeshtë.**
- **Është lloj i klimës së ngrohtë mesdhetare me të njëjtat kërkesa si mareja. Përsa i përket tokës tregohet pothuajse indiferent. Është i përhapur në pjesën Jugore të Ballkanit por takohet dhe në disa vende të Azisë. Tek ne gjendet në zonën e dafinës kryesisht ndërmjet Vlorës dhe Leskovikut. Ka dhe vlera dekorative.**

Vaccinium myrtillus L. – Boronicë
Familja Ericaceae

- **Shkurre e vogël, deri 50 cm lartësi. Gjethet i ka të rënëshme, vezake deri rrumbullake, përfundojnë me bishtak të shkurtër dhe pa shkëlqim, buzë pak të dhëmbëzuara. Lulet janë të veçuara si zilka, në sqetullat e gjetheve, të gjelbra në ngjyrë trëndafili, lulëzon në maj-korrik. Fruti është rrushk i ëmbël, më ngjyrë të zezë-të kaltër, i mbuluar nga një pluhurizë e hollë, piqet në mes të verës-shtator.**
- **Është bimë dritëdashëse deri gjysmëhije. Zakonisht vendoset në toka të murrme të pasura me humus. Është lloj Euroaziatik dhe i Amerikës së Veriut. Tek ne takohet në pyjet me ah dhe pak tek ato të pishës së zezë.**

Fraxinus ornus L. – Frashëri i bardhë
Familja oleace - Ullinjore

- **Arrin lartësi 10-12 m. ka kërcell kryesisht të drejtë, kurorë të gjerë, rruzullore. Sistemi rrënjor është boshtor, i thellë, me rrënjë të shumta anësore. Lëvorja është e lëmuar, ngjyrë hiri. Bisqet janë të shogët me ngjyrë gri-të verdhërremë. Gjethet janë të rënshmë, të përkundrejta, të përbëra, tekpendore, me 5 gjethëza heshtake-vezake, me buzë të sharruara, të dhëmbëzuara çrregullt, me push gjatë nervaturës së mesit nga poshtë. Lulet në melthe, të dendura, skajore, erëkëndëshme, me pjalmore të verdha, çelin prill-qershor. Fruti aken, me flatër (shojzë), heshtake, piqet në tetor.**

- **Është lloj nxehtësidashës dhe thatësirë dashës, preferon tokat gëlqerore dhe ato lehtësisht bazike. Shtrihet që nga Spanja deri në Turqi. Tek ne takohet deri në lartësinë 1700 m mbi nivelin e detit. Mund të përdoret për pyllëzimin e vendeve të zhveshura e të thata.**



Fraxinus angustifolia Vahl. – Frashëri fletëngushtë
Familja oleace - Ullinjore

- **Arrin lartësi deri 25 m. Lëvoren e ka gri, shpesh të murrme. Gjethet zakonisht janë me 5-13 gjethëza, të ngushta, vezake-heshtake, me buzë të sharruara ose të dhëmbëzuara, 3-10 cm të gjata. Lulet janë të zhveshura, me pjalmore të murrmë-të kuqërremta, çelin në mars-prill para gjethëzimit. Fruti shojzë heshtake, 3-4 cm, me majë të mprehtë.**

- **Rritet shpejt, shumëzohet me farë dhe lastarë. Është lloj i klimës mesdhetare, mbin në toka të tipeve të ndryshme, ka kërkesa ndaj lagështirës. Origjinën e ka nga pjesa Qëndrore dhe Jugore e Evropës, Afrika e Veriut dhe Azisë së Vogël. Tek ne takohet kryesisht në zonën e dafinës në vende me shumë ujë. Përdoret dhe nëpër parqe si lloj dekorativ.**



Phillyrea latifolia L- Krifsha fletëgjërë
Familja oleace - Ullinjore

- **Specie që rritet në trajtë shkurreje ose dru i përmasave të vogla deri në 8 m përherë igjelbër. Lëvorja është e lëmuar dhe më vonë plasaritet. Gjethet të qëndrueshme, të përkundrejta, të thjeshta, të lëkurta, vezake ose eliptike, të gjelbra, me buzë të dhëmbëzuara imët. Lulet janë të vogla, të bardha, erëkëndëshme, çelin në prill-maj. Fruti është bërthokël e zezë që piqet në shtator-tetor.**

- **E përhapur kryesisht në pellgun e Mesdheut, preferon klimë të ngrohtë. Tek ne i përhapur kudo në zonën e dafinës. Duron mjaft mirë kushtet e thatësirës.**

Phillyrea angustifolia L –Krifsha fletëngushtë
Familja oleace - Ullinjore

- **Rritet si shkurre, gjithmonë e gjelbër, kaçubore dhe shumë e degëzuar që nuk i kalon 2 m. Gjethet janë të qëndrueshme, të përkundrejta, të lëkurta, të gjelbra në të dyja faqet, vizake-heshtake me buzë të plota. Lulet janë të verdhëreme, erëkëndëshme, çelin në prill-maj. Fruti është bërthokël gati e zezë, me një thumb të vogël në majë.**
- **Është element tipik i florës mesdhetare të makies. Kërkon klimë të ngrohtë dhe mbin në çdo lloj toke. Tek ne gjendet kryesisht në Shqipërinë Jugore dhe në Divjakë.**

Jasminum officinale L. – Jasemini i bardhë
Familja oleace - Ullinjore

- **Shkurre kacavjerrëse, përherë e gjelbërt. Gjethet janë të gjelbra, të shndritshme, të përbëra, tekpendore. Lulet janë deri 2 cm të gjata, të bardha, shumë aromatike, në tufa skajore, lulëzon gjatë gjithë verës. Fruti është rrushk, piqet në gusht-shtator.**
- **Përhapet mjaft mirë në zonën e dafinës. është i qëndrueshëm ndaj ngricave dhe thatësirës. Ka nevojë për toka pjellore, mesatarisht të lagëta. I përhapur në Rusi, Azi Perëndimore dhe Himalaje. Tek ne përdoret gjërësisht si shkurre kacavjerrëse dekorative prej lules së bukur dhe aromës që lëshon.**

Jasminum fruticans L. – jasemini i verdhë
Familja oleace - Ullinjore

- **Shkurre përherë e gjelbër deri në 4 m lartësi. Gjethet janë tëpërbëra treshe, të vogla, të lëkurta, në formë lopatëe me majë të rrumbullakosur, në skaj të bisqeve gjethet janë të thjeshta. Lulet janë të verdha pa erë ose më aromë të lehtë, çelin në prill-maj. Fruti është rrushk i vogël, i zi, i shndritshëm dhe piqet në shtator.**
- **Kërkon klimë të ngrohtë mesdhetare, rezistent ndaj ngricave dhe ndaj thatësirës. Takohet në mënyrë spontane në Rusi, Iran dhe Mesdhe. Shumë i përshtatshëm për gardhe të gjallë ose bordurave apo dhe si shkurre të vetmuara për mbjellje në zona urbane.**

Syringa vulgaris L. – Jargavani
Familja oleace - Ullinjore

- **Rritet si shkurre ose dru i vogël deri 6 m. Lëvoren e ka ngjyrë hiri. Gjethet janë të thjeshta, të përkundrejta, vezake deri si zemër 6-12 cm të mëdha, të gjelbra të errëta. Lulet e jargavanit janë më ngjyra të ndryshme, ereëkëndëshme dhe në trajtë melthesh të dendura, çelin herët në maj. Fruti është kapsulë në formë elipsi që hapet më dysh kur piqet në shtator.**

- **Ka kërkesa të pakta për tokën, preferon dritën dhe nxehtësinë. Është i përhapur kryesisht në pjesën veriore të ballkanit ndërsa tek ne gjendet i kultivuar në parqe dhe lulishte.**

Ligustrum vulgare L. – Ligustër e rëndomtë
Familja oleace - Ullinjore

- **Shkurre që arrin deri 5 m lartësi, system rrënjor sipërfaqësor. Lëvorja është ngjyrë hiri-të murrme. Gjethet janë vezake të zgjatura-heshtake, gjithmonë të gjelbra dhe gjatë dimrit. Lulet janë me ngjyrë të bardhë, me erë të këndëshme, në melthe skajore, të ngritura përpjetë, çelin në prill-qershor. Fruti është rrushk i zi, i shndritshëm, piqet në tetor por qëndron në dru dhe gjatë dimrit.**

- **Ka amplitudë të gjërë ekologjike, rezistent ndaj ngricave e thatësirës. Përshtatet në toka të ndryshme, duron mjaft mirë hijëzimin. Origjinën e ka nga Evropa, Afrika e Veriut dhe Azia e Vogël. Tek ne takohet deri në lartësinë 1200 m mbi nivelin e detit. Vlerësohet si lloj dekorativ sepse mund të përdoret si gardh i gjelbër apo dhe prej kurorës që mund të krasitet në forma të ndryshme.**

Ligustrum lucidium Aiton – Ligustra gjethe shndritshme
Familja oleace - Ullinjore

- **Shkurre e madhe ose dru i vogël deri 10 m lartësi me kurorë të gjerë. Lëvorja e lëmuar ose me të çara shumë të holla, me ngjyrë gri, bisqet kanë lenticele të bardha. Gjethet janë të qëndrueshme, të përkundrejta, vezake-të zgjatura, me majë të mprehtë, sipër të gjelbra, të shndritshme, me ndervatura të dukshme, gjethet e reja janë të kuqërremta. Lulet janë të bardha, aromatike, pothuajse pa bisht, në melthe, lulëzon në qershor-gusht. Fruti është rrushk, blu i errët, piqet në tetor-dhjetor.**

- **Është përshtatur mirë kushteve klimës të zones së gështenjës. Është lloj hijedashës deri në njëfarë mase, mjaft rezistent ndaj ngricave dhe ndaj ndotjes në përgjithësi. Origjinën e ka nga Kina dhe Koreja, tek ne është i përhapur në parqe dhe lulishte si lloj dekorativ.**



Nerium oleander L. – Oleandri
Familja Apocynaceae

- Shkurre ose dru i vogël, me degë të gjata dhe të përkulëshme. Gjethet janë të qëndrueshme, të thjeshta, të lëkurta, në qerthuj me nga tre, heshtake, me buzë të plota me ngjyrë të gjelbër të fortë. Lulet janë hermafrodite, të mëdha, të vendosur në vastakë skajorë, të bardha ose të kuqërremta ose ngjyrë trëndafili dhe çelin në qershor-shtator. Fruti është rrëshekth deri 15 cm të gjata me ngjyrë të murrme kur piqet.

- Kërkon klimë të ngrohtë mesdhetare të ngrohtë. Është lloj dritëdashës dhe duron thatësirën gjithashtu mjaft i përshtatshëm për mbjellje në zona urbane. Konsiderohet si bimë toksike. Tek ne gjendet në gjendje spontane nga 400-500 m mbi nivelin e detit. Pra përdoret mjaft mirë si specie decorative në parqe, lulishte apo përgjatë rrugëve.

Paulownia tomentosa Sieb.&Zucc.- Paulonia
Familja Schrophulariaceae

- Dru gjetherënës deri 12 m lartësi. Kërcell të shkurtër e të trashë. Lëvorja është e hollë, e lëmuar me ngjyrë hir e ngjashme me arrën e hindit. Kurora shumë e gjerë. Gjethet janë të përkundrejta, shumë të mëdha, 15-25 cm në formë zemre ose me tre vriguj dhe me bisht 10-15 cm të gjatë. Lulet janë hermafrodite me aromë të këndëshme, në melthe skajore, të ngritura lart shumë dekorative, çelin në maj para gjethëzimit. Fruti është kapsulë, piqet në shtator.

- Paulonia është lloj i ndjeshëm ndaj ngricave, kërkon toka pjellore me lagështi të mjaftueshme. është tolerant ndaj ndotjes dhe ka temperament dritëdashës. Origjinën e ka nga Kina dhe tek ne gjendet në parqe dhe lulishte si lloj dekorativ. Sistemi rrënjor është mjaft i mirë për zbutjen e erozionit. Emrin Paulonia e ka marrë për nder të një princeshe hollandeze, Anna Pauloëna.

Catalpa bignonnoides walt. – Katalpa
Familja Bignoniaceae

- Dru deri 15 m lartësi, kërcelli është i shkurtër dhe i shtrembër. Lëvorja në rini është e lëmuar ndërsa tek të moshuarit është me mëlluga të holla ose plasaritje të cekëta. Kurorën e ka mjaft të dendur gjithashtu. Gjethet janë të mëdha 10 – 20 cm të gjata, vezake afërsisht si zemër, me buzë të plota e të valëzuara. Lulet janë hermafrodite, 5-7 cm të bardha me njolla të purpurta nga brenda dhe me dy vija të verdha deri 20 cm të gjata, çelin në qershor-korrik. Fruti është kapsulë në trajtë bishtaje e varur nga 20-40 cm e gjatë.

- Duron mjaft mirë kushtet e qytetit pra ndotjen urbane. Origjinën e ka nga Amerika e Veriut dhe tek ne takohet në trotuare, parqe dhe lulishte si lloj dekorativ. Mendohet së rrënjët i ka mjaft helmuese ndërsa lëvorja e saj është përdorur për kurimin e malarias, kundra helm për kafshim gjarpëri. Është futur në Evropë për herë të parë në Angli në vitin 1726. Emrin Catalpa e ka marrë nga keq shqiptimi i Cataëba (fis indian amerikan). Nuk kërkon shumë shërbim.



Campsis radicans L. Seem. – Kampsi
Familja Bignoniaceae

- **Shkurre kacavjerrëse me rrënjë të shumta ajrore ku me ndihmën e të cilave ngjitet në mure apo trungje pemësh deri 20 m lartësi. Gjethet janë të rënshme deri në 20 cm gjatësi, të përbëra, tekpendore me buzë të dhëmbëzuara, të gjelbra të errëta. Lulet janë me ngjyrë portokalli të grupuara në tufa skajore. Lulëzon bollshëm në korrik-gusht. Frutat janë kapsula të gjata, piqen në nëntor-dhjetor.**

- **Përhapur në zonën e dafinës dhe të gështenjës, rezistent ndaj thatësirës por vuan nga ngricat e dimrit. Origjinën e ka nga Amerika e Veriut. Vlerësohet si lloj dekorativ prej lules së bukur në periudhën e lulëzimit.**

Ruscus aculeatus L. – Rrushkulli
Familja - Liliaceae

- **Rritet në trajtë shkurreje, jo shumë e lartë, është gjithmonë e gjelbër. Kërcelli është i degëzuar. Gjethet janë shumë të vogla, mëllugore. Fruti është rrushk me ngjyrë të kuqe, qëndron në bimë gjatë gjithë dimrit.**

- **Rrushkulli është lloj i klimës medhetare, gjysëm hijedashës. Tek ne takohet deri në lartësinë 1000 m mbi nivelin e detit. Përdoret si lloj dekorative për bordure në parqe dhe kopshte.**

Viola alba Besser – Viola e bardhë
Familja Violaceae

Gjethet vezake të mprehta, me qime të shpërndara. Ndajgjethëzat vizake-heshtore. Lulet janë 1-2 cm, të bardha ose ngjyrë vjollcë. Gjendet në formë shkurretash, gardhesh dhe vende me bar.

Orchis albanica Gölz & H.R.Reinhard – Orkidea shqiptare
Familja Orchidaceae

Është bimë vendase e Evropës jugore. Lulëzon që në shkurt. Ngjyra e luleve është e purport por ka dhe nuance të tjera. Lartësia që arrin është deri në 40 cm.

Aster albanicus paparistoi – Ylli Shqiptar
Anacardiace

Kërcejt me gjethe të pakëta në gjysëm e poshtë. Lulet janë llapore nga 12 – 14, me ngjyrë vjollcë, 15 – 35 cm të gjata. Ato qëndrojnë në kaptinëza të vetmuara ose në vastakë të hapur me bisht të gjatë. Gjenden zakonisht në vende shkëmbore me natyrë serpentinore

Cyclamen hederifolium Ait – Bukëderri gjetheurthi
Familja Cycadaceae

Bimë barishtore shumë vjeçare, 10 – 20 cm me rrrënjë zhardhokore. Gjethet janë vezake të zgjatura, në formë zemre, të dhëmbëzuara. Lulet shfaqen në vjeshtë para se të dalin gjethet. Gjendet në shkurreta mesdhetare.

Linum bienne Miller – Liri dyvjeçar
Familja Liliaceae

Zakonisht bimë dyvjeçare, me shumë kërcej. Gjethet janë me 1-3 nervatura. Gjendet në vende të thata me bar, lulet i ka me ngjyrë vjollcë-blu.

Briza maxima L – Briza e madhe
Familja Boraginaceae (Gramineae)

Bimë njëvjeçare pa kërcej jo lulëzues, lloj bari. Kallinjtë jo më shumë se 12, të varur. Rritet deri në 60 cm lartësi. Gjendet në vende barishtore, gurishtore e me pyje të rrallë.

Atropa belladonna L – Helmarina
Familja Solanaceae

Bën pjesë tek familja e domates, bimë vendase e Evropës. Mund të klasifikohet dhe si shkurre e vogël. Lulet i ka të purpurta, gjethet janë jeshile dhe frutat që pasin piqen kthehen të zi. Të gjitha pjesët e saj janë shumë helmuese, sidomos gjethet dhe frutat.

Galium odoratum L – Ngjitësja erëmirë
Familja Rubiaceae

Bimë vendase e Evropës, mbillet gjerësisht si bimë dekorative. Rritet deri në 50 cm dhe ka një aromë mjaft të mirë. Gjethet janë me vriguj 6-9 të tillë. Lulet jan të bardha të vogla me petale të bardha. Preferon vendet me shumë hije dhe lagështi.

Festuca heterophylla Lam – Bishtëpelëza gjethendryshme
Familja Fagaceae

Lloj bari. Gjethet janë bazale në formë filli, të ashpra, me 3-5 tufa. Melthi është i madh. Kallithët janë deri në 1 cm. Gjendet në pyje e shkurreta të rralla. Bimë endemike e ballkanit.

Ononis spinosa L – Kalmuthi gjembor
Familja Onagraceae

Kurora me ngjyrë trëndafili ose e purport. Bimë zakonisht me gjemba. Gjethëzat janë gjatore ose vezak-gjatore. Lulet janë me ngjyrë rozë ose në të purport. Gjendet në vende të thata ose livadhe. Periudha e lulëzimit është maj – tetor. E përhapur në të gjithë Evropën. Mund të zhvillohet deri në 60 cm

Dactylis glomerata –Telishi
Familja Poaceae

Bimë barishtore shumë vjeçare. Kërcelli i lëmuar, i drejtë deri 100 cm. Melthi i përbërë me tufa të dendura, kallithët të vendosur në mënyrë jo të rregullt. Gjendet në vendeme pyje të rrallë, kullota e shkurreta.

Helleborus odorus Waldst Kit. – Shpendra
Familja Ranunculaceae

Gjethet janë vezake-heshtore, të lëkurta. Lulet janë të gjelbërta. Gjendet në kullota, pyje e shkurre të rralla.

Digitalis grandiflora Miller – Luletogëza lulemadhe
Familja Plantaginaceae

Lule këmbanore, me grykë të gjatë. Bishti dhe kupa me qime gjëmbore. Kërcelli mund të arrijë nga 70 – 120 cm Gjendet në pyje, shkurreta, e kullota. Të gjitha pjesët janë helmuese.

Melica uniflora Retz – Bjelisha njëlulëshe
Familja Meliaceae

Lloj bari vendas i Evropës kryesisht. Gjendet kryesisht në lartësi 900 – 1200 m mbi nivelin e detit, në pyjet me ah ose halore. Zakonisht kërkon toka të thata.

Brachypodium sylvaticum Beauv – Rudithi pyjor
Familja poaceae

Gjendet kryesisht në pyje nën kurorën e drurëve por mund të rriten dhe në çeltira. Preferon kushtet e thata të tokës dhe i shmanget lagështirës. Mund të rritet deri në 30 cm lartësi. Shumë insekte e kanë si bazë ushqimore.

Cistus albanicus Earburg – Menishtja shqiptare
Familja Cistaceae

Gjethet gati pa bisht, si pykë në baze, me qime. Lulet të bardha me diametër 4-6 cm. Bima rritet deri në 25 cm në vende të thata e shkurreta. Është bimë endemike.



Lilium albanicum Jav – Zambaku shqiptar
Familja Liliaceae

Lule të verdha, portokalli 1-2 ose në tufa. Gjethet janë me qerpikë vetëm në buzë. Rritet nga 30 – 80 cm, në livadhe, e shpate shkëmbore. Bimë endemike e Shqipërisë.